



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 111

Tiranë – E enjte, 27 korrik 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 52/2023, datë 6.7.2023	Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë..... 11715
Dekret i Presidentit nr. 146, datë 24.7.2023	Për shpallje ligji..... 11729
Dekret i Presidentit nr. 145, datë 21.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 11729
Dekret i Presidentit nr. 147, datë 25.7.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 11729
Dekret i Presidentit nr. 154, datë 25.7.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 11729
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 419, datë 7.7.2023	Për miratimin e fushave dhe nënfushave prioritare të zhvillimit të vendit dhe të shtesës së veçantë të kushtëzuar..... 11730
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 101, datë 24.7.2023	Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Brendshme..... 11732
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 475, datë 20.7.2023	Për miratimin e formës së dokumentit të identifikimit të Përmbauesit Gjyqësor Shtetëror..... 11734
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 15.6.2023	Çështja Mariglen Avdiu dhe të tjerë kundër Shqipërisë (kërkesa nr. 49516/17)..... 11735
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 22.6.2023	Çështja Zeqo dhe SEAT sh.p.k. kundër Shqipërisë (kërkesat nr. 61445/12 dhe 53157/15)..... 11738
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 22.6.2023	Kërkesa nr. 56080/19, 2001 sh.p.k. kundër Shqipërisë..... 11741

Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, datë 22.6.2023	Çështja Rabije Haka kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 34712/18</i>).....	11743
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 216, datë 4.7.2023	Mbi njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike, lëshuar nga zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, për subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k.”	11745
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 217, datë 4.7.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Global Technical Mechanics” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	11746
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 218, datë 4.7.2023	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 16, datë 23.1.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Diezela’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ljusa”, me kapacitet të instaluar 1980 kw”.....	11747
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 219, datë 4.7.2023	Mbi pezullimin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Eu Green Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku eolik i erës “Dropulli wind”, me kapacitet të instaluar 20 mw.....	11749
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 68/9, datë 25.7.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion dhe ndërtim i rrugëve ‘Ksanthipi Zyko’ dhe ‘Abdyl Ypi’, Bashkia Durrës”.....	11750
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 374/9, datë 27.7.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Miratimi i masterplanit strategjik Durrës-Porto-Romano 2030, faza 1-Studimi i Fizibilitetit për ndërtimin, përditësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës portuale të portit të integruar të Durrësit në Porto-Romano”.....	11753



LIGJ
Nr. 52/2023

**PËR ARBITRAZHIN NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti i ligjit**

Ky ligj përcakton rregullat për organizimin dhe zhvillimin e procedurave të arbitrazhit vendas dhe ndërkombëtar kur vendi i arbitrazhit është në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 2
Qëllimi i ligjit**

Ky ligj ka si qëllim krijimin e kuadrit ligjor për organizimin dhe zhvillimin e procedurave të arbitrazhit, si dhe garantimin e organizimit të zhvillimit të procedurave të arbitrazhit në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.

**Neni 3
Përkufizime**

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Arbitër” është personi fizik, i caktuar në përputhje me parashikimet e këtij ligji për të shqyrtuar dhe zgjidhur mosmarrëveshjen midis palëve nëpërmjet procedurës së arbitrazhit.

2. “Arbitrazh” është procedura përmes së cilës palët vullnetarisht caktojnë një arbitër ose një trup gjykues arbitrash për shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të cilat rrjedhin nga një marrëdhënie juridike e caktuar, që kanë lindur ose që

mund të lindin ndërmjet tyre pavarësisht nëse mosmarrëveshjet janë me natyrë kontraktore ose jo.

3. “Arbitrazh ndërkombëtar” është procedura e shqyrtimit dhe zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje kur:

a) palët në kohën e lidhjes së marrëveshjes së arbitrazhit kanë vendbanimin, vendqëndrimin ose selinë në shtete të ndryshme; ose

b) vendi i arbitrazhit sipas marrëveshjes së arbitrazhit, ose vendi me të cilin mosmarrëveshja, objekt i arbitrazhit, lidhet më ngushtë ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; ose

c) një pjesë thelbësore e detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhënia juridike, objekt i mosmarrëveshjes, përmbushet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

4. “Institucion i përhershëm arbitrazhi” është një person juridik, i themeluar nga persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, sipas ligjit shqiptar, që ka si objekt të veprimtarisë së tij organizimin e procedurave të arbitrazhit.

5. “Gjykata” është trup ose organ i sistemit gjyqësor të Republikës së Shqipërisë.

6. “Gjykata e arbitrazhit” është një arbitër ose një trup gjykues arbitrash, të caktuar sipas rregullave të parashikuara në marrëveshjen e arbitrazhit ose nga ky ligj për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje.

7. “Marrëveshje arbitrazhi” është marrëveshja midis palëve për të shqyrtuar dhe zgjidhur përmes arbitrazhit të gjitha ose disa mosmarrëveshje që rrjedhin nga një marrëdhënie juridike e caktuar, që kanë lindur ose që mund të lindin ndërmjet tyre, pavarësisht nëse mosmarrëveshjet janë me natyrë kontraktore ose jo. Marrëveshja e arbitrazhit mund të jetë pjesë e një kontrate në formën e një klauzole arbitrazhi ose një marrëveshjeje të posaçme.

8. “Vendi i arbitrazhit” është vendi i caktuar nga palët për zhvillimin e procedurës së arbitrazhit.

**Neni 4
Fusha e zbatimit**

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjitha procedurat e arbitrazhit vendas dhe ato të arbitrazhit ndërkombëtar, kur vendi i arbitrazhit është në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Neni 11 i këtij ligji zbatohet edhe në rastet kur vendi i arbitrazhit është jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ose kur vendi i arbitrazhit nuk është përcaktuar në marrëveshjen e arbitrazhit.



Neni 5

Roli i gjykatave në procedurat e arbitrazhit

Gjykata nuk mund të shqyrtojë çështjet që rregullohen nga ky ligj, përveç kur ligji parashikon ndryshe.

Neni 6

Organizimi i arbitrazhit

1. Procedura e arbitrazhit mund të organizohet nga një institucion i përhershëm arbitrazhi, sipas rregullave procedurale të tij dhe përcaktimeve të këtij ligji, kur marrëveshja e arbitrazhit parashikon që procedura e arbitrazhit zhvillohet nga një institucion i përhershëm arbitrazhi.

2. Palët mund të bien dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjes nëpërmjet arbitrazhit *ad hoc*. Procedura e arbitrazhit *ad hoc* zhvillohet sipas rregullave të përcaktuara nga palët në marrëveshjen e arbitrazhit, si dhe sipas përcaktimeve të këtij ligji.

KREU II

MARRËVESHJA E ARBITRAZHIT

Neni 7

Objekti i marrëveshjes së arbitrazhit

Objekti i një marrëveshjeje arbitrazhi mund të jetë çdo pretendim pasuror ose kërkesë që rrjedh nga një marrëdhënie pasurore, me përjashtim të rastit kur legjislacioni i posaçëm e ndalon zgjidhjen e mosmarrëveshjes nëpërmjet arbitrazhit ose kur përcakton që zgjidhja e një mosmarrëveshjeje nëpërmjet arbitrazhit mund të kryhet vetëm në kushte të caktuara.

Neni 8

Marrëveshja për arbitrazh

1. Një mosmarrëveshje mund të shqyrtohet dhe të zgjidhet përmes arbitrazhit vetëm nëse ekziston një marrëveshje mes palëve, me anë të cilës ato pranojnë t'ia nënshtrojnë arbitrazhit mosmarrëveshjet me karakter pasuror që kanë lindur ose mund të lindin nga një marrëdhënie juridike, pavarësisht nëse mosmarrëveshjet janë me natyrë kontraktore ose jo.

2. Palët mund të lidhin një marrëveshje arbitrazhi edhe nëse mosmarrëveshja mes tyre është duke u

shqyrtuar nga gjykata, përveç rasteve kur zgjidhja e mosmarrëveshjes është nën juridiksionin ekskluziv të gjykatës.

3. Marrëveshja e arbitrazhit mund të lidhet nga çdo person fizik ose juridik privat. Zotësia e personave fizikë dhe juridikë privatë për të lidhur një marrëveshje arbitrazhi dhe për të qenë palë në një procedurë arbitrazhi rregullohet sipas ligjit të posaçëm që përcakton fitimin e zotësisë për të vepruar.

4. Marrëveshja e arbitrazhit mund të lidhet edhe nga një ministri ose një njësi e vetëqeverisjes vendore. Institucioni i varësisë, agjencia autonome, si dhe shoqëria shtetërore mund të lidhë një marrëveshje arbitrazhi pas marrjes së pëlqimit paraprak, sipas rastit, të ministrit përgjegjës ose Kryeministrit. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të lidhin një marrëveshje arbitrazhi pas marrjes së pëlqimit paraprak, sipas rastit, nga këshilli bashkiak ose këshilli i qarkut.

Neni 9

Forma e marrëveshjes së arbitrazhit

1. Marrëveshja e arbitrazhit bëhet me shkrim, ndryshe është e pavlefshme.

2. Marrëveshja e arbitrazhit plotëson formën e kërkuar sipas këtij neni edhe nëse vullneti i palëve shprehet përmes faksit, telegramit, teleksit, postës elektronike apo mjeteve të tjera të komunikimit ose regjistrimit të të dhënave, të cilat mund të dokumentohen dhe të sigurojnë një provë të shkruar të marrëveshjes së arbitrazhit.

3. Në rastet kur njëra palë është konsumator sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatorëve, marrëveshja e arbitrazhit duhet të nënshkruhet personalisht nga palët dhe të jetë e veçantë dhe e pavarur nga marrëveshja bazë.

4. Klauzola e marrëveshjes së arbitrazhit, kur është pjesë e një kontrate apo marrëveshjeje, përbën një marrëveshje të posaçme dhe të pavarur nga kushtet e tjera të kontratës. Pavlefshmëria e kontratës nuk sjell *ipso jure* pavlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit.

5. Përjashtimisht, marrëveshja e arbitrazhit është e vlefshme edhe kur, pavarësisht se palët nuk kanë zbatuar parashikimet e këtij neni për formën e marrëveshjes, ka filluar procedura e arbitrazhit dhe



pala tjetër nuk ka kundërshtuar mungesën e juridiksionit të gjykatës së arbitrazhit.

Neni 10

Interpretimi i marrëveshjes së arbitrazhit

Në rast dyshimi mbi juridiksionin e gjykatës së arbitrazhit për të shqyrtuar mosmarrëveshjen, marrëveshja e arbitrazhit ose kushtet e saj interpretohen duke u bazuar në qëllimin që palët kanë për t'ia nënshtuar mosmarrëveshjen arbitrazhit.

Neni 11

Marrja e masave të përkohshme përpara formimit të gjykatës së arbitrazhit

1. Palët mund të kërkojnë marrjen e masave të përkohshme nga gjykata përpara formimit të gjykatës së arbitrazhit, kur pala provon se nga mosmarrja e masës mund t'i vijë një dëm i rëndë dhe i pariparueshëm.

2. Palët mund të kërkojnë marrjen e masave të përkohshme nga gjykata edhe në rastet kur vendi i arbitrazhit është jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ose kur vendi i arbitrazhit nuk është përcaktuar në marrëveshjen e arbitrazhit. Në këtë rast kompetenca territoriale e gjykatës për marrjen e masave të përkohshme caktohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

Neni 12

Paditë përpara gjykatave

1. Kur ngrihet një padi për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, që është objekt i marrëveshjes së arbitrazhit, gjykata, edhe kryesisht, vendos nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, përveç rastit kur marrëveshja e arbitrazhit është haptazi e pavlefshme.

2. Kur procedura e arbitrazhit ka filluar, nuk mund të ngrihet padi në gjykatë për pavlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit.

KREU III ARBITRAT

Neni 13

Kushtet për të qenë arbitër

1. Arbitër mund të jetë vetëm personi fizik që ka zotësi të plotë juridike për të vepruar.

2. Arbitri duhet të jetë i pavarur dhe i paanshëm.

3. Arbitri duhet të plotësojë kriteret e kualifikimit ose kushtet e zgjedhshmërisë të caktuara në marrëveshjen e arbitrazhit apo rregulloren e institucionit të përhershëm të arbitrazhit.

4. Përveç kualifikimeve profesionale të arbitrit, të përcaktuara në marrëveshjen midis palëve apo rregulloren e institucionit të përhershëm të arbitrazhit, arbitri duhet të plotësojë njëkohësisht edhe kushtet e mëposhtme:

a) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

b) të mos jetë ndaluar nga e drejta për të ushtruar funksione publike me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Neni 14

Numri i arbitrave

1. Gjkata e arbitrazhit përbëhet nga një arbitër i vetëm ose nga një trup gjykues arbitrash sipas përcaktimit të marrëveshjes së arbitrazhit. Në rastet kur marrëveshja e arbitrazhit përcakton shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga një trup gjykues arbitrash, palët janë të lira të përcaktojnë numrin e arbitrave, me kusht që numri i arbitrave të jetë numër tek.

2. Në rast se në marrëveshjen e arbitrazhit nuk përcaktohet numri i arbitrave dhe palët nuk bien dakord për të, numri i arbitrave do të jetë tre.

Neni 15

Emërimi i arbitrave

1. Procedura e emërimit të arbitrave përcaktohet nga palët në marrëveshjen e arbitrazhit. Në rast se në marrëveshjen e arbitrazhit nuk përcaktohet procedura e emërimit të arbitrave apo palët nuk bien dakord për të, arbitrat emërohen sipas parashikimit të këtij neni.

2. Në rast se palët kanë rënë dakord që procedura e arbitrazhit organizohet nga një institucion i përhershëm arbitrazhi, arbitrat ose arbitri i vetëm, sipas përcaktimit të marrëveshjes së arbitrazhit ose këtij ligji, emërohet nga lista e arbitrave në përputhje me rregullat procedurale të institucionit të përhershëm të arbitrazhit, duke u bazuar në parimin e barazisë së palëve.

3. Në rast se palët kanë rënë dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjes nëpërmjet arbitrazhit *ad hoc*, secila palë ka të drejtë të emërojë një arbitër jo më



vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga fillimi i procedurës së arbitrazhit. Të dy arbitrat, me marrëveshje, emërojnë arbitrin e tretë, i cili është njëkohësisht edhe kryesuesi i trupit gjykues të arbitrave, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e emërimit të tyre. Në rast se gjykata e arbitrazhit përbëhet nga një arbitër i vetëm, palët duhet të emërojnë arbitrin e vetëm brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga fillimi i procedurës të arbitrazhit.

4. Në rast se një nga palët nuk ka emëruar arbitrin ose dy arbitrat nuk kanë emëruar arbitrin e tretë, si dhe në rastet kur gjykata e arbitrazhit përbëhet nga një arbitër i vetëm, palët nuk kanë emëruar arbitrin e vetëm brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, arbitri, sipas rastit, emërohet nga një palë e tretë, e përcaktuar nga palët në marrëveshjen e arbitrazhit. Në rastet kur marrëveshja e arbitrazhit nuk përcakton emërimin e arbitrit nga një palë e tretë ose pala e tretë nuk emëron arbitrin brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, arbitri emërohet nga gjykata e rrethit gjyqësor të vendit të arbitrazhit.

5. Përveç kur palët kanë rënë dakord ndryshe, pala, e cila ka emëruar arbitrin dhe ka njoftuar palën tjetër për emërimin e tij, nuk mund të zëvendësojë ose të shkarkojë arbitrin pa pëlqimin e palës tjetër.

6. Gjikata e rrethit gjyqësor të vendit të arbitrazhit emëron arbitrin, sipas këtij neni, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës, përveç rastit kur marrëveshja e arbitrazhit nuk ekziston ose është haptazi e pavlefshme. Gjikata, përpara emërimit të arbitrit, merr edhe mendimin e palëve.

7. Në emërimin e arbitrit gjykata merr në konsideratë cilësitë dhe kualifikimet profesionale sipas përcaktimeve të palëve në marrëveshjen e arbitrazhit ose që janë të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, si dhe çdo rrethanë tjetër që garanton emërimin e një arbitri të pavarur dhe të paanshëm. Gjikata, kur e çmon të përshtatshme, mund të emërojë arbitrin nga lista e arbitrave të institucioneve të përhershme të arbitrazhit.

8. Arbitri, i cili nuk pranon të kryejë këtë detyrë, duhet të njoftojë gjykatën, duke dhënë argumentet përkatëse, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja dijeni për emërimin. Në këtë rast gjykata cakton një arbitër tjetër sipas procedurës së përcaktuar në këtë nen.

9. Kundër vendimit të gjykatës për emërimin e arbitrit nuk lejohet ankim.

Neni 16

Pranimi i detyrës nga arbitri

1. Gjikata e arbitrazhit formohet në datën që arbitri i vetëm ose të gjithë arbitrat pranojnë detyrën.

2. Arbitri pranon detyrën përmes një deklarate me shkrim, nëpërmjet së cilës deklaron edhe që nuk ekzistojnë shkaqe që mund të krijojnë një dyshim të arsyeshëm për mungesën e pavarësisë ose paanësisë së tij, si dhe që plotëson kriteret e kualifikimit ose kushtet e zgjedhshmërisë, të caktuara në marrëveshjen e arbitrazhit.

Neni 17

Rastet e mbarimit të mandatit të arbitrit

Mandati i arbitrit mbaron në rastet kur:

- a) heq dorë nga detyra;
- b) përjashtohet nga shqyrtimi i mosmarrëveshjes sipas përcaktimit të neneve 18 dhe 19 të këtij ligji;
- c) palët bien dakord për përfundimin e mandatit të tij;
- d) gjykata e rrethit gjyqësor të vendit të arbitrazhit ka pranuar kërkesën e palëve apo të njërit prej arbitrave të tjerë për përfundimin e mandatit;
- e) i hiqet apo kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- dh) nuk plotëson më kushtet për të qenë arbitër sipas përcaktimeve të këtij ligji, marrëveshjes së arbitrazhit ose rregullores së institucionit të përhershëm të arbitrazhit;
- e) përfundon procedura e arbitrazhit sipas këtij ligji.

Neni 18

Përjashtimi i arbitrit

1. Arbitri është i detyruar të njoftojë palët ose të heqë dorë nga shqyrtimi dhe zgjidhja e një mosmarrëveshjeje në rastet kur:

- a) nuk plotëson kriteret e kualifikimit ose kushtet e zgjedhshmërisë të caktuara në marrëveshjen e arbitrazhit;
- b) ka qenë përfaqësues i ndonjëres prej palëve, ose ekspert apo dëshmitar në një çështje ose mosmarrëveshje ku kanë marrë pjesë të njëjtat palë;
- c) ai vetë ose bashkëshortja ka interes në një çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me mosmarrëveshjen, objekt i marrëveshjes së arbitrazhit;



ç) ai vetë ose bashkëshortja është i afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërin nga palët ose përfaqësuesit e tyre;

d) është në marrëdhënie pune me ndonjërin nga palët ose përfaqësuesit e tyre ose ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në shqyrtim, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njëres apo tjetres palë;

dh) ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve ose njërin prej përfaqësuesve;

e) është kujdestar, punëdhënës i njëres prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që ka interesa për mosmarrëveshjen që është objekt i marrëveshjes së arbitrazhit;

ë) në çdo rast tjetër kur vërtetohen rrethana të tjera që krijojnë dyshime të arsyeshme për paanësinë ose pavarësinë e arbitrit.

2. Arbitri, i cili vlerëson se ka shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin dhe zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje, është i detyruar të njoftojë palët ose të heqë dorë prej saj jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e emërimit ose e marrjes dijeni për shkakun e përjashtimit.

3. Arbitri është i detyruar të njoftojë palët për çdo rrethanë që mund të krijojë dyshime të arsyeshme për pavarësinë ose paanësinë e tij jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marrja dijeni, me përjashtim të rastit kur provohet se palët kanë marrë dijeni për këto rrethana.

4. Palët kanë të drejtë të kundërshtojnë emërimin ose të kërkojnë përjashtimin e një arbitri kur ekziston një nga shkaqet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Pala mund të kërkojë përjashtimin e arbitrit të emëruar prej saj vetëm në rastet kur shkaqet për përjashtimin e arbitrit kanë lindur pas emërimit të tij ose pala ka marrë dijeni për shkaqet e përjashtimit pas emërimit të tij.

Neni 19

Procedura për përjashtimin e arbitrit

1. Palët kanë të drejtë të përcaktojnë procedurën e përjashtimit të arbitrit në marrëveshjen e arbitrazhit ose në një marrëveshje të posaçme. Në rast se në marrëveshjen e arbitrazhit nuk

përcaktohet procedura e përjashtimit të arbitrit dhe palët nuk bien dakord për të, përjashtimi i arbitrit kryhet sipas parashikimeve të këtij neni.

2. Palët mund të kërkojnë me shkrim përjashtimin e arbitrit jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja dijeni për shkakun e përjashtimit ose jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga formimi i gjykatës së arbitrazhit kur pala ka marrë dijeni për shkaqet e përjashtimit përpara formimit të gjykatës së arbitrazhit. Kërkesa për përjashtimin e arbitrit i dërgohet palës tjetër dhe gjykatës së arbitrazhit dhe duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet përjashtimi i arbitrit.

3. Në rast se arbitri nuk heq dorë nga shqyrtimi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjes ose pala tjetër nuk pranon përjashtimin e arbitrit, kërkesa për përjashtimin e arbitrit shqyrtohet nga gjykata e arbitrazhit jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e kërkesës.

4. Në çdo rast, kur kërkesa për përjashtimin e arbitrit, e paraqitur sipas procedurës së posaçme të përcaktuar nga palët sipas pikës 1 të këtij neni ose sipas procedurave të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, është rrëzuar, palët kanë të drejtë të paraqesin një kërkesë për përjashtimin e arbitrit pranë gjykatës së rrethit gjyqësor të vendit të arbitrazhit jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga njoftimi ose marrja dijeni për vendimin e rrëzimit të kërkesës. Gjykata e shqyrton kërkesën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga depozitimi i saj dhe, pasi thërret dhe dëgjon palët, vendos për pranimin ose rrëzimin e kërkesës.

5. Kundër vendimit të gjykatës për pranimin ose rrëzimin e kërkesës nuk lejohet ankim.

6. Shqyrtimi i kërkesës për përjashtimin e arbitrit nga gjykata nuk pezullon procedurat e arbitrazhit ose marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata e arbitrazhit.

Neni 20

Moskryerja e detyrës

1. Kur për shkak të ligjit, rrethanave të faktit ose për çfarëdo arsye tjetër, një arbitër nuk është në gjendje të përmbushë detyrat e tij, apo nuk kryen ose vonon kryerjen e një veprimi që lidhet me ushtrimin e funksioneve të tij, mandati i tij përfundon nëse heq dorë nga detyra ose nëse palët bien dakord për përfundimin e mandatit të tij.



2. Kur arbitri nuk jep dorëheqjen ose kur palët nuk bien dakord për përfundimin e mandatit të tij, palët ose secili prej arbitrave të gjykatës së arbitrazhit mund të kërkojnë nga gjykata e rrethit gjyqësor të vendit të arbitrazhit përfundimin e mandatit të arbitrit.

3. Gjkata e shqyrton kërkesën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga depozitimi i saj dhe, pasi thërret dhe dëgjon palët, si dhe arbitrin ndaj të cilit është kërkuar përfundimi i mandatit, vendos për pranimin ose rrëzimin e kërkesës.

4. Kundër vendimit të gjykatës për pranimin ose rrëzimin e kërkesës nuk lejohet ankim.

Neni 21

Zëvendësimi i arbitrit

Kur mandati i arbitrit përfundon në përputhje me nenet 17, 18, 19 dhe 20 të këtij ligji, ose kur ai jep dorëheqjen, zëvendësimi i arbitrit bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara për emërimin e arbitrave, përveç kur në marrëveshjen e arbitrazhit parashikohet ndryshe.

KREU IV JURIDIKSIONI I GJYKATËS SË ARBITRAZHIT

Neni 22

Juridiksioni i gjykatës së arbitrazhit

1. Gjkata e arbitrazhit ka të drejtë të marrë në shqyrtim dhe të vendosë nëse mosmarrëveshja në shqyrtim është në juridiksionin e saj, si dhe të përcaktojë vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit.

2. Pretendimi për mungesën e juridiksionit të gjykatës së arbitrazhit duhet të parashtrohet jo më vonë se data e dorëzimit të deklaratës së mbrojtjes. Palët kanë të drejtë të parashtrojnë pretendime për mungesën e juridiksionit të gjykatës së arbitrazhit edhe nëse kanë emëruar ose kanë marrë pjesë në emërimin e një arbitri. Pretendimi që gjykata e arbitrazhit ka tejkaluar juridiksionin duhet të parashtrohet në të njëjtin moment kur çështja që pretendohet të jetë jashtë juridiksionit të gjykatës së arbitrazhit paraqitet për shqyrtim përpara gjykatës së arbitrazhit. Gjkata e arbitrazhit mund ta pranojë pretendimin për tejkalimin e juridiksionit edhe kur nuk paraqitet në të njëjtin moment me paraqitjen e

çështjes para gjykatës së arbitrazhit, me kusht që të paraqitet brenda 30 ditëve nga paraqitja e çështjes për shqyrtim në gjykatën e arbitrazhit dhe provohet se vonesa ka qenë për shkaqe të arsyeshme.

3. Gjkata e arbitrazhit, në rastet kur çmon që ka juridiksionin për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, vendos rrëzimin e kërkesës me vendim të ndërmjetëm. Ndaj vendimit të ndërmjetëm palët mund të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor të vendit të arbitrazhit jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga njoftimi ose marrja dijeni për vendimin e rrëzimit të kërkesës. Gjkata e shqyrton kërkesën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga depozitimi i saj dhe, pasi thërret e dëgjon palët, vendos për pranimin ose rrëzimin e ankimit.

4. Shqyrtimi i ankimit sipas pikës 3 të këtij neni, nuk pezullon procedurat e arbitrazhit ose marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata e arbitrazhit.

Neni 23

Masat e përkohshme

1. Përveç kur palët bien dakord ndryshe, gjykata e arbitrazhit, me kërkesën e njëres prej palëve, mund të vendosë marrjen e masave të përkohshme nëse pala paraqet prova me shkrësë, që vërtetojnë se ekziston mundësia e ardhjes së një dëmi të rëndë e të pariparueshëm gjatë kohës së shqyrtimit të mosmarrëveshjes në rast se nuk merret një masë e tillë. Gjkata e arbitrazhit mund të kërkojë nga palët që të japin një garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata e arbitrazhit, për dëmin që mund të shkaktohet nga marrja e masës së përkohshme.

2. Gjkata e rrethit gjyqësor të vendit të arbitrazhit, me kërkesë të palës, mund të urdhërojë ekzekutimin e masës së përkohshme të vendosur nga gjykata e arbitrazhit, përveç rasteve kur kërkesa për marrjen e një mase të ngjashme të përkohshme është paraqitur më parë në gjykatë sipas parashikimit të nenit 11 të këtij ligji. Gjkata, pavarësisht se kërkesa është paraqitur më parë në gjykatë, sipas parashikimit të nenit 11 të këtij ligji, kur e çmon të nevojshme ekzekutimin e masës së përkohshme të vendosur nga gjykata e arbitrazhit, mund të urdhërojë ekzekutimin e saj.

3. Gjkata, me kërkesë të palëve, mund të shfuqizojë ose të ndryshojë vendimin për urdhërimin e ekzekutimit të masës së përkohshme.

4. Vendimi i gjykatës për urdhërimin e ekzekutimit të masës së përkohshme, të vendosur



nga gjykata e arbitrazhit, si dhe vendimi për shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit për urdhërimin e ekzekutimit të masës së përkohshme ekzekutohen drejtpërdrejt nga shërbimi përmbarimor pas njoftimit të vendimit.

5. Në rast se provohet që masa e përkohshme e vendosur nga gjykata e arbitrazhit, sipas pikës 1 të këtij neni, ishte e paarsyeshme, pala që ka kërkuar marrjen e masës së përkohshme është e detyruar të shpërblejë dëmin që ka ardhur nga ekzekutimi i masës së përkohshme. Gjykata e arbitrazhit ka juridiksionin për të shqyrtuar kërkesën për arsyeshmërinë e masës së përkohshme, si dhe shpërblimin e dëmit në rastet kur masa e përkohshme provohet si e paarsyeshme.

KREU V ZHVILLIMI I PROCEDURËS SË ARBITRAZHIT

Neni 24 Rregulla të përgjithshme

1. Gjykata e arbitrazhit kujdeset për zhvillimin e rregullt të procedurës së arbitrazhit nëpërmjet garantimit të kushteve të njëjta e të barabarta për çdo palë.

2. Gjykata e arbitrazhit garanton të drejtën e palëve për të paraqitur mjetet dhe faktet për të cilat mbështesin pretendimet e tyre, provat dhe dispozitat ligjore që do t'u referohen, në mënyrë që të bëhet e mundur për secilën palë mbrojtja e interesave të tyre në procedurat e arbitrazhit, sipas parimit të kontradiktoritetit.

3. Përpara gjykatës së arbitrazhit, palët mund t'i kryejnë veprimet personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar. Palët janë të lira të zgjedhin përfaqësuesit e tyre, të cilët do t'i përfaqësojnë ato në procedurën e arbitrazhit. Përfaqësuesi i autorizuar nga pala nuk mund të përjashtohet nga procedura e arbitrazhit.

4. Përveç rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe, palët kanë të drejtë të përcaktojnë rregullat për zhvillimin e procedurës së arbitrazhit ose mund t'u referohen rregullave procedurale të një institucioni të përhershëm arbitrazhi. Në rast se në marrëveshjen e arbitrazhit nuk përcaktohen rregullat procedurale dhe palët nuk bien dakord për to, zbatohen dispozitat e këtij ligji. Kur një çështje nuk rregullohet nga dispozitat e këtij ligji, gjykata e arbitrazhit ka të

drejtë të përcaktojë rregullat procedurale përkatëse, duke zbatuar me analogji dispozitat e Kodit të Procedurës Civile ose rregullat procedurale të një institucioni të përhershëm arbitrazhi.

Neni 25 Vendi i arbitrazhit

1. Palët kanë të drejtë të caktojnë vendin e arbitrazhit në marrëveshjen e arbitrazhit. Në rast se nuk është caktuar nga palët, vendi i arbitrazhit përcaktohet nga gjykata e arbitrazhit, duke mbajtur në konsideratë rrethanat e mosmarrëveshjes, si dhe përshtatshmërinë për palët.

2. Në rast se procedura e arbitrazhit organizohet nga një institucion i përhershëm arbitrazhi, vendi i arbitrazhit, kur nuk është caktuar nga palët, caktohet sipas rregullave procedurale të institucionit të përhershëm të arbitrazhit.

3. Gjykata e arbitrazhit, pavarësisht parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni, përveç rasteve kur palët kanë rënë dakord ndryshe, mund të mbledhet në çdo vend që e çmon të përshtatshëm për mbajtjen e seancës dëgjimore, pyetjen e dëshmitarëve, ekspertëve ose palëve, diskutimin ndërmjet arbitrave, si dhe për këqyrjen në vend të sendeve ose të dokumenteve.

Neni 26 Gjuha

1. Palët kanë të drejtë të përcaktojnë gjuhën ose gjuhët që përdoren në procedurën e arbitrazhit. Në rast se në marrëveshjen e arbitrazhit nuk përcaktohet gjuha ose gjuhët që do të përdoren apo palët nuk bien dakord për to, gjuha ose gjuhët që përdoren në procedurën e arbitrazhit përcaktohen nga gjykata e arbitrazhit, duke pasur në konsideratë vendin e arbitrazhit, si dhe gjuhën që palët kanë përdorur në marrëveshjen e arbitrazhit.

2. Në rast se procedura e arbitrazhit organizohet nga një institucion i përhershëm arbitrazhi, gjuha ose gjuhët që përdoren në procedurën e arbitrazhit, kur nuk janë caktuar nga palët, mund të caktohen sipas rregullave procedurale të institucionit të përhershëm të arbitrazhit.

3. Marrëveshja ndërmjet palëve ose vendimi i gjykatës së arbitrazhit për përcaktimin e gjuhës, përveç kur është përcaktuar ndryshe, zbatohet edhe për çdo shpjegim dhe pretendim me shkrim të



paraqitur nga palët për çdo seancë dëgjimore, si dhe për çdo vendim ose njoftim tjetër të kryer nga gjykata e arbitrazhit.

4. Gjykata e arbitrazhit mund të urdhërojë që çdo provë me shkrësë të paraqitet së bashku me përkthimin në gjuhën ose gjuhët e caktuara me marrëveshje midis palëve ose të përcaktuar nga gjykata e arbitrazhit.

5. Kërkesa për arbitrazh, kërkesëpadia, deklarata e mbrojtjes, kundërpadia dhe çdo parashtrim ose shpjegim tjetër deri në datën e përcaktimit të gjuhës ose gjuhëve që përdoren në procedurën e arbitrazhit, mund të paraqiten në gjuhën e kontratës që përmban klauzolën e arbitrazhit, në gjuhën e marrëveshjes së arbitrazhit ose në gjuhën shqipe.

Neni 27

Njoftimet dhe llogaritja e afateve

1. Palët kanë të drejtë të përcaktojnë procedurën e njoftimit të akteve në marrëveshjen e arbitrazhit ose në një marrëveshje të posaçme. Në rast se në marrëveshjen e arbitrazhit nuk përcaktohet procedura e njoftimit të akteve dhe palët nuk bien dakord për të, njoftimi i akteve kryhet sipas parashikimeve të këtij neni.

2. Çdo njoftim me shkrim mund t'i dorëzohet personalisht marrësit ose t'i dërgohet nëpërmjet postës së porositur në:

- a) vendbanimin ose vendqëndrimin e tij;
- b) në çdo vend ku marrësi ndodhet, përfshirë edhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;
- c) selinë ose çdo vend ku ushtron veprimtarinë marrësi, në rastin e personave juridikë;
- ç) adresën e përcaktuar në kontratë ose në marrëveshjen e arbitrazhit;
- d) çdo vend tjetër të përcaktuar dhe të njoftuar paraprakisht nga marrësi.

3. Nëse asnjë prej vendeve të sipërpërmendura nuk mund të gjendet, njoftimi me shkrim quhet i kryer në rast se i dërgohet marrësit nëpërmjet postës së porositur në adresën e fundit të regjistruar të vendbanimit, vendqëndrimit, selisë ose adresën e tij postare.

4. Njoftimi me shkrim quhet i kryer sipas pikave 1 e 2 të këtij neni në datën e dorëzimit personalisht të njoftimit ose në datën kur është dorëzuar në një nga vendet e sipërpërmendura. Njoftimi me shkrim quhet i kryer edhe nëse marrësi refuzon ta pranojë

atë, si dhe nuk di ose nuk mund të nënshkruajë. Në këtë rast, bëhet shënimi në kopjen e njoftimit dhe, kur është e mundur, vërtetohet edhe me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm.

5. Njoftimi mund të kryhet edhe nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik ose me faks në rast se palët kanë rënë dakord paraprakisht për kryerjen e njoftimeve nëpërmjet këtyre mjeteve. Në këtë rast, njoftimi quhet i kryer në rast se marrësi konfirmon me shkrim ose nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik marrjen e njoftimit.

6. Afatet për kryerjen e veprimeve procedurale të caktuara nga ky ligj llogariten nga dita e nesërme e dorëzimit të njoftimit. Kur afati është caktuar me ditë dhe me orë, përjashtohet dita dhe ora në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Afati që është caktuar në javë, në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.

7. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për njoftimin e akteve nga gjykata.

Neni 28

Fillimi i procedurës së arbitrazhit

Përveç kur palët kanë rënë dakord ndryshe, procedura e arbitrazhit fillon në datën kur pala tjetër ka marrë kërkesën për të shqyrtuar dhe zgjidhur një mosmarrëveshje nëpërmjet arbitrazhit. Kërkesa për të shqyrtuar dhe zgjidhur një mosmarrëveshje nëpërmjet arbitrazhit duhet të përmbajë emrin e palëve, objektin e mosmarrëveshjes, si dhe i referohet marrëveshjes së arbitrazhit.

Neni 29

Kërkesëpadia, deklarata e mbrojtjes dhe kundërpadia

1. Paditësi është i detyruar të paraqesë kërkesëpadinë dhe provat për të cilat mbështet kërkesëpadinë, si dhe i padituri është i detyruar të paraqesë deklaratën e mbrojtjes, si dhe provat për të cilat mbështetet deklarata e mbrojtjes brenda afatit të caktuar nga palët ose në rastet kur palët nuk kanë caktuar një afat, brenda afatit të caktuar nga gjykata



e arbitrazhit. Palët mund t'i bashkëngjisin kërkesëpadisë ose deklaratës së mbrojtjes edhe çdo akt tjetër provues, si dhe të përcaktojnë çdo provë tjetër që mund të merret.

2. Përveç kur palët kanë rënë dakord ndryshe, palët kanë të drejtë të shtojnë, të pakësojnë ose të ndryshojnë kërkesëpadinë ose deklaratën e mbrojtjes. Palët nuk mund të shtojnë, të pakësojnë ose të ndryshojnë kërkesëpadinë ose deklaratën e mbrojtjes kur gjykata e arbitrazhit çmon që kërkesa për shtimin, pakësimin ose ndryshimin është paraqitur me vonesë dhe shkakton zvarritje të shqyrtimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

3. I padituri ka të drejtë të paraqesë kundërpadi kur kërkimi i kundërpadisë bazohet në të njëjtën marrëdhënie juridike për të cilën palët kanë lidhur marrëveshjen e arbitrazhit. Kundërpadia paraqitet së bashku me deklaratën e mbrojtjes ose në një fazë të mëvonshme të procedurës së arbitrazhit, kur gjykata e arbitrazhit, duke marrë në konsideratë rrethanat e rastit, çmon që vonesa në paraqitjen e kundërpadisë është për shkaqe të justifikuara. Për paraqitjen e kundërpadisë zbatohen të njëjtat rregulla të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 30

Seancat dëgjimore dhe procedurat me shkrim

1. Përveç kur palët kanë rënë dakord ndryshe, gjykata e arbitrazhit ka të drejtë të vendosë nëse shqyrtimi i çështjes bëhet në bazë të dokumenteve dhe materialeve të tjera me shkrim pa praninë e palëve apo çështja do të shqyrtohet në seancë dëgjimore me praninë e palëve. Seanca dëgjimore mund të zhvillohet me praninë fizike të palëve ose edhe nëpërmjet ndërlidhjes audiovizive në distancë të tyre. Gjkata e arbitrazhit mund të vendosë edhe që të shqyrtojë çështjen duke kombinuar të dyja procedurat. Përveç rasteve kur palët kanë përjashtuar shqyrtimin e çështjes në seancë dëgjimore, gjykata e arbitrazhit, kur kërkohet nga pala, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë dëgjimore në një fazë të përshtatshme të gjykimit. Seanca dëgjimore zhvillohet me dyer të mbyllura, përveç rasteve kur palët kanë rënë dakord ndryshe.

2. Gjkata e arbitrazhit u njofton palëve datën dhe orën e çdo seance dëgjimore, si dhe të çdo mbledhjeje që ka si qëllim marrjen e provave në mënyrë të rregullt e në kohë, me qëllim që të

garantojë mundësinë e palëve për të mbrojtur interesat e tyre.

3. Çdo deklaratë, dokument, akt provues ose informacion tjetër, i cili i paraqitet gjykatës së arbitrazhit nga njëra palë, i dërgohet edhe palës tjetër. Palëve u dërgohet edhe çdo raport me shkrim që përgatitet nga ekspertët, si dhe çdo dokument ose akt tjetër provues në të cilin bazohet gjykata e arbitrazhit për marrjen e vendimit.

Neni 31

Pasojat juridike të mospërmbyshjes së detyrimeve nga palët

1. Në rast se paditësi, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqet kërkesëpadinë sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 29 të këtij ligji, gjykata e arbitrazhit vendos pushimin e gjykimit.

2. Në rast se i padituri pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk paraqet deklaratën e mbrojtjes sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 29 të këtij ligji, gjykata e arbitrazhit vijon shqyrtimin e çështjes. Mosparaqitja e deklaratës së mbrojtjes nga i padituri nuk duhet të konsiderohet si pranim i pretendimeve të paditësit, të parashtruara në kërkesëpadi.

3. Nëse ndonjë nga palët nuk paraqitet në seancën dëgjimore ose nuk paraqet prova shkresore brenda afatit të caktuar nga gjykata, gjykata e arbitrazhit mund të vijojë gjykimin dhe në përfundim të tij të vendosë zgjidhjen e mosmarrëveshjes duke u bazuar në provat e marra.

4. Në çdo rast, pavarësisht parashikimeve të pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, palët kanë të drejtë të caktojnë me marrëveshje pasojat juridike të mospërmbyshjes së detyrimeve, të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 32

Provat

1. Palët kanë detyrimin të provojnë faktet për të cilat bazohen kërkimet dhe pretendimet e tyre.

2. Gjkata e arbitrazhit ka të drejtë të përcaktojë mënyrën e marrjes së provave, rëndësinë e tyre për çështjen, saktësinë e vërtetësinë e tyre, si dhe vlerën e tyre provuese.

3. Gjkata e arbitrazhit, në çdo kohë gjatë gjykimit, mund të kërkojë nga palët që brenda afatit të caktuar prej saj të paraqesin dokumente ose akte të tjera provuese.



Neni 33 Dëshmitarët

1. Përveç kur palët kanë rënë dakord ndryshe, dëshmitarët dëgjohen nga gjykata e arbitrazhit në seancë dëgjimore.

2. Dëshmitarët, me pëlqimin e palëve, mund të pyeten nga gjykata e arbitrazhit jashtë seancës dëgjimore. Gjukata e arbitrazhit mund të vendosë që dëshmitë e dëshmitarëve të merren nëpërmjet deklaratave me shkrim. Në këtë rast, gjykata e arbitrazhit cakton një afat brenda të cilit dëshmitari duhet të paraqesë deklaratën me shkrim, si dhe deklaratat të nënshkruhet nga dëshmitari. Në çdo rast, palët kanë të drejtë t'i bëjnë pyetje plotësuese dëshmitarit për të sqaruar apo plotësuar përgjigjet e dhëna nga ai.

3. Dëshmitarët dëgjohen dhe pyeten nga gjykata e arbitrazhit duke zbatuar, për aq sa është e mundur, parashikimet e legjislacionit procedural civil për pyetjen e dëshmitarëve.

Neni 34 Ekspertët

1. Përveç kur palët kanë rënë dakord ndryshe, gjykata e arbitrazhit mund të caktojë një ose më shumë ekspertë, të cilët duhet të paraqesin mendimin e tyre me shkrim për çështje të caktuara nga gjykata e arbitrazhit.

2. Gjukata e arbitrazhit mund të urdhërojë një palë për t'i lejuar ekspertit kryerjen e detyrave të caktuara nga gjykata e arbitrazhit, nëpërmjet njohjes me sende, evidenca, llogari e dokumente të tjera ose të lejojë këqyrjen në vend të tyre.

3. Pas marrjes së raportit me shkrim, gjykata e arbitrazhit ua dërgon raportin palëve, të cilat kanë të drejtë të paraqesin mendimin dhe vërejtjet e tyre me shkrim për raportin e ekspertimit. Përveç kur palët kanë rënë dakord ndryshe, gjykata e arbitrazhit, me kërkesë të palëve ose kryesisht, pas depozitimit të raportit me shkrim, mund të thërrasë në seancë dëgjimore ekspertin për të dhënë shpjegime dhe për të parashtruar përfundimet e ekspertimit dhe, pasi të ketë dhënë mendimin, ekspertit mund t'i bëhen pyetje. Në seancën dëgjimore, palët mund të thërrasin ekspertët e tyre, me qëllim që të paraqesin mendimin për çështjet e caktuara nga gjykata e arbitrazhit ose të japin sqarime plotësuese për to.

4. Palët kanë të drejtë të kundërshtojnë emërimin ose të kërkojnë përjashtimin e një eksperti kur ekziston një nga shkaqet e përcaktuara në nenin 18 të këtij ligji.

Neni 35 Mbështetja e gjykatës në marrjen e provave

1. Gjukata e arbitrazhit ose palët, pas miratimit nga gjykata e arbitrazhit, mund të kërkojnë nga gjykata kompetente e rrethit gjyqësor marrjen e provave ose kryerjen e çdo veprimi tjetër juridik që nuk mund të kryhet nga gjykata e arbitrazhit për shkak të mungesës së juridiksionit për kryerjen e veprimit.

2. Kompetenca e gjykatës së rrethit gjyqësor, si dhe rregullat për marrjen e provave ose kryerjen e veprimeve të tjera juridike caktohen në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast, arbitrat kanë të drejtë të marrin pjesë në marrjen e provave, si dhe të bëjnë pyetje.

Neni 36 Heqja dorë nga e drejta për kundërshtim

Pala që është në dijeni të shkeljes së një dispozite të këtij ligji apo të mospërmbyshjes nga pala tjetër të një detyrimi që rrjedh nga marrëveshja e arbitrazhit dhe, pavarësisht kësaj, vijon procedurën e arbitrazhit duke mos kundërshtuar menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marrja dijeni për shkeljen përkatëse, konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta për kundërshtim.

KREU VI VENDIMI I GJYKATËS SË ARBITRAZHIT

Neni 37 Rregullat e zbatueshme për themelin e mosmarrëveshjes

1. Në procedurat e arbitrazhit ndërkombëtar, gjykata e arbitrazhit e zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me parashikimet e legjislacionit material në fuqi, të zgjedhur nga palët. Në rast se palët nuk kanë përcaktuar legjislacionin e zbatueshëm, gjykata e arbitrazhit zbaton legjislacionin e përcaktuar nga rregullat e së drejtës ndërkombëtare private. Në të gjitha rastet e tjera gjykata e arbitrazhit zbaton legjislacionin shqiptar.



2. Gjykata e arbitrazhit mund të vendosë zgjidhjen e mosmarrëveshjes sipas parimit *ex aequo et bono* ose *amiable compositeur* vetëm nëse palët kanë rënë dakord shprehimisht.

3. Gjykata e arbitrazhit, në të gjitha rastet, vendos në përputhje me kushtet e kontratës dhe merr në konsideratë zakonet e mira tregtare të zbatueshme për marrëdhënien juridike që ekziston ndërmjet palëve.

Neni 38

Marrja e vendimit

1. Përveç kur palët kanë rënë dakord ndryshe, vendimi i gjykatës së arbitrazhit merret me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të saj. Arbitrat që kanë mendim të kundërt me shumicën kanë të drejtë t'i parashtrojnë me shkrim mendimet e tyre. Vendimi i nënshkruar nga shumica e arbitrave ka të njëjtin efekt sikur të jetë nënshkruar nga të gjithë arbitrat.

2. Veprimet procedurale, si dhe kërkesat për kryerjen e tyre mund të shqyrtohen dhe të vendosen nga kryesuesi i trupit gjykues të arbitrave ose një nga arbitrat në rast se kanë rënë dakord palët ose të gjithë anëtarët e trupit gjykues të arbitrave.

Neni 39

Forma dhe përmbajtja e vendimit

1. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit hartohet me shkrim dhe duhet të përmbajë:

- a) përbërjen e trupit gjykues të arbitrave;
- b) vendin e arbitrazhit;
- c) identitetin e palëve dhe përfaqësuesve të tyre;
- ç) të dhëna rreth marrëveshjes së arbitrazhit dhe pretendimeve përfundimtare të palëve;
- d) paraqitjen e përmbledhur të arsytimit;
- dh) dispozitivin e vendimit;
- e) nënshkrimin e arbitrave;
- ë) datën e marrjes së vendimit;
- f) sekretarinë e gjykatës;
- g) vendin e depozitimit të një nga kopjet origjinale të vendimit.

2. Vendimi nënshkruhet personalisht nga arbitri apo arbitrat, sipas rastit. Vendimi është i vlefshëm edhe nëse nënshkruhet nga shumica e arbitrave, me kushtin që në vendim të shpjegohen shkaqet për mungesën e nënshkrimeve të tjera.

3. Vendimi hartohet në një ose më shumë kopje origjinale. Vendimi njoftohet në përputhje me

rregullat e përcaktuara nga palët. Në rast se palët nuk kanë përcaktuar rregulla për njoftimin e vendimit, vendimi njoftohet nëpërmjet dorëzimit të origjinalit ose të një kopjeje të njëzuar me origjinalin nga arbitrat ose institucioni i përhershëm i arbitrazhit.

4. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit është përfundimtar dhe i formës së prerë për marrëveshjen e shqyrtuar që nga data e shpalljes.

5. Vendimi bëhet publik vetëm me pëlqimin e palëve.

Neni 40

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me mirëkuptim

1. Palët kanë të drejtë që gjatë zhvillimit të procedurës së arbitrazhit, të përpiqen të zgjidhin mosmarrëveshjen me mirëkuptim.

2. Kur palët zgjidhin mosmarrëveshjen me mirëkuptim, i paraqesin gjykatës së arbitrazhit marrëveshjen e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Kjo marrëveshje, me kërkesë të palëve, miratohet me vendim të gjykatës së arbitrazhit, me përjashtim të rastit kur përmbajtja e marrëveshjes është në kundërshtim me rendin publik. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit për miratimin e marrëveshjes për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me mirëkuptim merret në përputhje me parashikimet e nenit 39 të këtij ligji dhe ka efekt të njëjtë me çdo vendim tjetër të marrë për themelin e çështjes.

3. Me miratimin e marrëveshjes së palëve për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me mirëkuptim, gjykata e arbitrazhit vendos përfundimin e procedurës së arbitrazhit.

Neni 41

Përfundimi i procedurave të arbitrazhit

1. Procedura e arbitrazhit përfundon kur gjykata e arbitrazhit merr një vendim përfundimtar për zgjidhjen në themel të çështjes ose kur vendos pushimin e gjykimit për një nga shkaqet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

2. Gjykata e arbitrazhit vendos pushimin e gjykimit kur:

- a) paditësi, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqet kërkesëpadinë sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 29 të këtij ligji;



b) paditësi tërheq kërkesëpadinë; Përfundimisht, gjykata e arbitrazhit mund të vijojë gjykimin e çështjes, me kërkesën e të paditurit, në rast se çmon që i padituri ka një interes të ligjshëm për zgjidhjen përfundimisht të mosmarrëveshjes;

c) palët bien dakord për pushimin e gjykimit të mosmarrëveshjes;

ç) palët nuk vijnë me procedurat e arbitrazhit, pavarësisht kërkesës së gjykatës së arbitrazhit ose kur gjykata e arbitrazhit çmon se vazhdimi i procedurave për çdo arsye tjetër është bërë i panevojshëm ose i pamundur.

3. Mandati i gjykatës së arbitrazhit mbaron me përfundimin e procedurave të arbitrazhit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj.

Neni 42

Shpenzimet procedurale

1. Përveç kur palët kanë rënë dakord ndryshe, gjykata e arbitrazhit cakton shpenzimet procedurale në vendimin përfundimtar. Në shpenzime përfshihen:

a) tarifa e gjykatës së arbitrazhit;

b) shpenzimet dhe shpërblimet e arbitrave;

c) shpenzimet për ekspertët dhe për çdo ndihmë tjetër, të cilën e ka kërkuar gjykata e arbitrazhit dhe për të cilat palët kanë rënë dakord;

ç) shpenzimet për udhëtimin dhe shpenzimet e tjera të dëshmitarëve deri në masën e miratuar nga gjykata e arbitrazhit;

d) shpenzimet për përfaqësimin dhe këshillimin ligjor; në çdo rast, kompensimi i shpenzimeve për përfaqësimin dhe këshillimin ligjor duhet kërkuar gjatë procedurës së arbitrazhit dhe njihet nga gjykata e arbitrazhit vetëm deri në atë masë që gjykohej i arsyeshëm.

dh) të gjitha taksat dhe shpenzimet e gjykatës në rast se ka emëruar ndonjë nga arbitrat.

2. Shpenzimet procedurale duhet të jenë të arsyeshme, duke marrë parasysh kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, kohën e shpenzuar nga arbitrat dhe rrethanat e tjera të çështjes. Mosmarrëveshjet për shpenzimet procedurale shqyrtohen dhe zgjidhen nga gjykata e arbitrazhit.

3. Përveç kur palët kanë rënë dakord ndryshe, shpenzimet procedurale të paguara nga paditësi i ngarkohen të paditurit në masën e pjesës së padisë që është pranuar nga gjykata e arbitrazhit dhe

shpenzimet procedurale të paguara nga i padituri paguhen nga paditësi në përpjesëtim me pjesën e refuzuar të padisë. Gjikata e arbitrazhit mund t'i ngarkojë një palë shpenzimet procedurale, pavarësisht nga masa e pranuar ose e rrëzuar e padisë, në rastet kur diktohet nga rrethanat e çështjes ose sjellja e palës gjatë procedurave të arbitrazhit.

4. Në rastet kur shpenzimet procedurale mund të caktohen vetëm pas përfundimit të procedurës së arbitrazhit, shpenzimet caktohen me një vendim të posaçëm të gjykatës së arbitrazhit.

Neni 43

Ndreqja e gabimeve, interpretimi dhe plotësimi i vendimit të arbitrazhit

1. Përveç kur palët kanë rënë dakord ndryshe, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e vendimit të arbitrazhit, palët mund të kërkojnë nga gjykata e arbitrazhit:

a) të ndreqë gabimet e bëra në shkrim ose në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të vendimit;

b) të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ajo ka dhënë, kur ky është i paqartë;

c) të plotësojë vendimin në rast se gjykata e arbitrazhit nuk është shprehur për të gjitha pretendimet e paraqitura nga pala.

2. Çdo kërkesë, sipas pikës 1 të këtij neni, i njoftohet edhe palës tjetër.

3. Gjikata e arbitrazhit, edhe kryesisht, mund të ndreqë çdo gabim sipas përcaktimit të shkronjës "a" të pikës 1 të këtij neni, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit. Gjikata e arbitrazhit, kur çmon se kërkesa është e bazuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës ndreq gabimet, ose jep sqarime apo bën interpretimin e vendimit.

4. Kur gjykata e arbitrazhit çmon që kërkesa për plotësimin e vendimit duhet pranuar, si dhe në rast se nuk është e nevojshme mbajtja e një seance dëgjimore ose marrja e provave, vendos plotësimin e vendimit jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e marrjes së kërkesës.

5. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit për ndreqjen e gabimeve, sqarimin ose interpretimin e vendimit, si dhe për plotësimin e saj merret në përfundim me parashikimet e nenit 38 të këtij ligji.



KREU VII
ANKIMI KUNDËR VENDIMIT TË
GJYKATËS SË ARBITRAZHIT

Neni 44

Anulimi i vendimit të gjykatës së arbitrazhit

1. Mjeti për t'u ankuar ndaj një vendimi të gjykatës së arbitrazhit është vetëm kërkesa për anulimin e vendimit të gjykatës së arbitrazhit. Kërkesa për anulimin e vendimit të gjykatës së arbitrazhit paraqitet në gjykatën e apelit me juridiksion të përgjithshëm, në juridiksionin e së cilës është vendi i arbitrazhit, për shkaqet e mëposhtme:

a) njëra nga palët e marrëveshjes së arbitrazhit nuk ka pasur zotësinë për të vepruar sipas ligjit të posaçëm që përcakton fitimin e zotësisë për të vepruar, si dhe organizimin e funksionimit të tyre; ose

b) marrëveshja e arbitrazhit është e pavlefshme sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi të përzgjedhur nga palët ose nga gjykata e arbitrazhit, ose, në rastet kur palët nuk kanë përcaktuar legjislacionin e zbatueshëm, sipas parashikimeve të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë; ose

c) palët nuk janë njoftuar rregullisht për emërimin e një arbitri ose për fillimin e procedurës së arbitrazhit, si dhe për çdo shkak tjetër, që nuk ka lejuar palët të paraqesin mbrojtjen e tyre; ose

ç) vendimi ka zgjidhur një mosmarrëveshje që nuk është shqyrtuar nga gjykata e arbitrazhit ose vendimi ka zgjidhur një mosmarrëveshje që nuk ishte pjesë e marrëveshjes së arbitrazhit, si edhe një ose disa mosmarrëveshje të zgjidhura nga gjykata e arbitrazhit nuk ishin në juridiksionin e saj. Në këtë rast, kur është e mundur që vendimi për mosmarrëveshjet, që ishin nën juridiksionin e gjykatës së arbitrazhit, të ndahet nga ajo pjesë e vendimit për mosmarrëveshjet që nuk ishin pjesë e juridiksionit të saj, gjykata anulon vetëm atë pjesë të vendimit të gjykatës së arbitrazhit që ka zgjidhur mosmarrëveshjet që nuk ishin nën juridiksionin e saj; ose

d) përbërja e gjykatës së arbitrazhit ose procedura e arbitrazhit nuk ishte në përputhje me dispozitat e këtij ligji ose me marrëveshjen e arbitrazhit, me kushtin që shkelja e tyre të jetë me pasoja për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes nga gjykata e arbitrazhit; ose

dh) vendimi ka zgjidhur një mosmarrëveshje që ndalohet nga ligji që të zgjidhet nëpërmjet arbitrazhit; ose

e) ekzekutimi i vendimit do të ishte në kundërshtim me rendin publik.

2. Përveç kur palët kanë rënë dakord ndryshe, kërkesa për anulimin e vendimit të gjykatës së arbitrazhit bëhet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të gjykatës së arbitrazhit. Në rast se një palë ka kërkuar ndreqjen e gabimeve, interpretimin ose plotësimin e vendimit, sipas parashikimit të nenit 43 të këtij ligji, afati fillon të llogaritet nga data e njoftimit të vendimit të gjykatës së arbitrazhit për pranimin ose rrëzimin e kërkesës.

3. Kur gjykata e apelit vendos anulimin e vendimit, mund që, në rast se çmohet e arsyeshme, të vendosë edhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e arbitrazhit ose të urdhërojë ndërmarrjen e çdo veprimi tjetër që mënjanon shkaqet e anulimit të vendimit.

Neni 45

Shqyrtimi nga gjykata e apelit

1. Gjkata e apelit e shqyrton kërkesën për anulimin e vendimit sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile për shqyrtimin e çështjeve në apel.

2. Gjkata e apelit e shqyrton ankimin brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga depozitimi i tij në gjykatë.

3. Paraqitja e kërkesës për anulimin e vendimit nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës së arbitrazhit. Përrjashtimisht, gjykata, me kërkesën e palës, mund të pezullojë ekzekutimin e vendimit kur vlerëson se ka rrezik që palës mund t'i shkaktohet një dëm i madh e i pariparueshëm.

4. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

KREU VIII
NJOHJA DHE EKZEKUTIMI I
VENDIMEVE TË GJYKATAVE TË
ARBITRAZHIT

Neni 46

**Vendimet e një gjykate arbitrazhi në
Republikën e Shqipërisë**

1. Vendimet e gjykatave të arbitrazhit, kur vendi i arbitrazhit është në Republikën e Shqipërisë,



përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim pas nxjerrjes së urdhrat të ekzekutimit nga gjykata e rrethit gjyqësor në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

2. Gjykata e rrethit gjyqësor refuzon kërkesën për lëshimin e urdhrat të ekzekutimit në rast se çmon që ekzistojnë një ose disa nga shkaqet për anulimin e vendimit sipas nenit 44 të këtij ligji. Kur kërkesa për anulimin e vendimit është shqyrtuar nga gjykata e apelit sipas nenit 44 të këtij ligji, gjykata e rrethit gjyqësor nuk mund të shqyrtojë nëse ekzistojnë një ose disa nga shkaqet për anulimin e vendimit.

Neni 47

Vendimet e një gjykate arbitrazhi jashtë Republikës së Shqipërisë

1. Njohja e vendimit përfundimtar të një gjykate arbitrazhi jashtë Republikës së Shqipërisë bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në Konventën për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit të Nju Jork-ut, 10 qershor 1958, e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8658, datë 9.11.2000, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit”, si dhe Kodin e Procedurës Civile.

2. Shkaqet për refuzimin e njohjes së vendimit përfundimtar të arbitrazhit të një shteti të huaj përfshijnë rastet kur:

a) sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja nuk mund të jetë në juridiksionin e gjykatës së arbitrazhit që ka dhënë vendimin;

b) palët në marrëveshjen e arbitrazhit, në bazë të ligjit të zbatueshëm për to, nuk kishin zotësi të plotë për të vepruar, ose marrëveshja në fjalë nuk është e vlefshme sipas ligjit të cilit i janë nënshtruar palët ose mungon ndonjë përcaktim sipas ligjit të vendit ku është dhënë vendimi ose palës kundër së cilës jepet vendimi;

c) kërkesëpadia nuk i është njoftuar palës tjetër në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t'i dhënë atij mundësi që të mbrohet apo nuk i është dhënë njoftimi i rregullt për caktimin e arbitrit ose të procedurës së arbitrazhit ose pala ka qenë e paafte për të paraqitur rastin e saj;

ç) vendimi trajton një mosmarrëveshje të paparashikuar në marrëveshjen për arbitrazh ose nuk hyn në klauzolën për arbitrazhin ose përmban

vendime për çështjet që tejkalojnë fushën që i nënshtrohet arbitrazhit; Megjithatë në qoftë se vendimet për çështje që i nënshtrohen arbitrazhit mund të veçohen nga ato që nuk i janë nënshtruar, ajo pjesë e vendimit, e cila përmban vendime për çështje që i nënshtrohen arbitrazhit, mund të njihet dhe të ekzekutohet;

d) përbërja e autoritetit të arbitrazhit ose e procedurës së arbitrazhit nuk ishte në përputhje me marrëveshjen e palëve ose mungon një marrëveshje e tillë;

dh) gjykata konstaton se:

i. objekti i mosmarrëveshjes nuk mund të zgjidhet me arbitrazh sipas legjislacionit shqiptar;

ii. ekzekutimi i vendimit do të ishte në kundërshtim me rendin publik.

KREU IX

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 48

Dispozita kalimtare

1. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për procedurat e arbitrazhit që kanë filluar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur palët kanë rënë dakord shprehimisht ndryshe.

2. Çështjet që janë në gjykim në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji në gjykatën e shkallës së parë, në gjykatën e apelit ose në Gjykatën e Lartë, do të vazhdojnë të gjykohen sipas dispozitave të ligjit në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesëpadisë.

Neni 49

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 6.7.2023.

Shpallur me dekretin nr. 146, datë 24.7.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 146, datë 24.7.2023****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 52/2023, “Për arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 145, datë 21.7.2023****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Alketa Nuredin Cena
2. Borana Agron Memo
3. Oni Memo
4. Indrit Ismet Miftari
5. Kledis Jon Indrit Miftari
6. Melissa Indrit Miftari

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 147, datë 25.7.2023****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Enxhi Albert Destani
2. Aida Nexhat Krasniqi
3. Marsela Besnik Gega
4. Ermal Miltiadh Mici
5. Thomas Georg Ermal Mici

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 154, datë 25.7.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 8, nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Arian Osmon Kuqi



2. Eris Florim Kajtazi
3. Fiola Petrit Grezda
4. Dafina Hysen Maloku
5. Hate Brahim Feraj (Lushaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 419, datë 7.7.2023

**PËR MIRATIMIN E FUSHAVE DHE
NËNFUSHAVE PRIORITARE TË
ZHVILLIMIT TË VENDIT DHE TË
SHITESËS SË VEÇANTË TË
KUSHTËZUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “d” e “dh”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kuptim të këtij vendimi, konsiderohen fusha prioritare të zhvillimit të vendit:
 - a) zhvillimi i sektorit të shoqërisë së informacionit e të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (qeverisja elektronike), e fokusuar në nënfushat, si më poshtë vijon:

- i. infrastruktura dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, përfshirë projektimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe ngritjen e rrjeteve;

- ii. ndërveprimet dhe transaksionet elektronike nëpërmjet shërbimeve të besuara, përfshirë integrimin me sistemet e informacionit të Bashkimit Evropian;

- iii. siguria e bazave të të dhënave shtetërore, përfshirë auditimin e sistemeve TIK;

- iv. hartimi i akteve rregullatore në fushën TIK.

- b) zhvillimi i infrastrukturës së informacionit kombëtar gjeohapësinor, e fokusuar në nënfushat, si më poshtë vijon:

- i. Përmirësimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës;

- ii. Mbledhja, administrimi dhe përpunimi i informacionit gjeohapësinor;

- iii. Hartimi i akteve rregullatore në fushën e sistemeve të informacionit kombëtar gjeohapësinor.

2. Shtesa e veçantë e kushtëzuar mbi pagën bruto mujore për pozicionet e punës që kryejnë funksione, sipas fushave dhe nënfushave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, për një periudhë kohe 4 (katër)-vjeçare, përcaktohet në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 korrik 2023 dhe për vitin 2023 përballohen nga fondet e kontingjencës, të miratuara për këtë vit.

4. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



Lidhja nr. 1

Shtesa e veçantë e kushtëzuar për nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit

Pozicioni	Shtesa e veçantë e kushtëzuar (lekë/muaj)
Titullar i institucionit.	92 000
Zëvendës drejtor i përgjithshëm dhe drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes përgjegjëse për funksionet e infrastrukturave dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, përfshirë projektimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe ngritjen e rrjeteve, ndërveprimet dhe transaksionet elektronike, nëpërmjet shërbimeve të besuara, përfshirë integrimin me sistemet e informacionit të Bashkimit Evropian funksionet siguria e bazave të të dhënave shtetërore, përfshirë auditimin e sistemeve TIK dhe hartimi i akteve rregullatore në fushën TIK.	90 000
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes përgjegjëse për funksionet e programimit, zhvillimit, menaxhimit, infrastrukturave sistemeve dhe sigurisë së informacionit, përditësimit të shërbimeve elektronike, mirëmbajtjen dhe ngritjen e rrjeteve, ndërveprimet dhe transaksionet elektronike, auditimin e sistemeve TIK nëpërmjet shërbimeve të besuara.	70 000
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes përgjegjëse për funksionet e regjistrimit të bazave të të dhënave shtetërore, përfshirë menaxhimin dhe zhvillimin e projekteve, integrimin me sistemet e informacionit të Bashkimit Evropian dhe asistencën ndaj qytetarit.	50 000
Specialist në drejtoritë apo në sektorët e përmbajtjes përgjegjëse për funksionet e programimit, zhvillimit, menaxhimit, infrastrukturave sistemeve dhe sigurisë së informacionit, përditësimit të shërbimeve elektronike, mirëmbajtjen dhe ngritjen e rrjeteve, ndërveprimet dhe transaksionet elektronike, auditimin e sistemeve TIK nëpërmjet shërbimeve të besuara.	50 000
Specialist në drejtoritë apo sektorët e përmbajtjes përgjegjëse për funksionet e regjistrimit të bazave të të dhënave shtetërore, përfshirë menaxhimin dhe zhvillimin e projekteve, integrimin me sistemet e informacionit të Bashkimit Evropian dhe asistencën ndaj qytetarit.	30 000

Shtesa e veçantë e kushtëzuar për nëpunësit e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

Pozicioni	Shtesa e veçantë e kushtëzuar (lekë/muaj)
Titullar i institucionit.	65 000
Zëvendës drejtor i përgjithshëm.	60 000
Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes përgjegjëse për funksionet e monitorimit të territorit me teknologji të avancuar, të GIS kombëtar, të gjeodezisë dhe hartografisë, të akteve rregullatore në fushën e sistemeve të informacionit kombëtar gjeohapësinor, të koordinimit dhe projekteve si dhe kërkim-zhvillimit dhe inovacionit.	55 000
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes përgjegjëse për funksionet e monitorimit të territorit me teknologji të avancuar, të GIS kombëtar, të gjeodezisë dhe hartografisë.	45 000
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes përgjegjëse për funksionet e hartim-monitorimit të standardeve, të gjeoportalit kombëtar, koordinimit dhe projekteve, si dhe kërkim-zhvillimit dhe inovacionit.	40 000
Specialist në drejtoritë apo sektorët e përmbajtjes përgjegjëse për funksionet e monitorimit të territorit me teknologji të avancuar, të GIS kombëtar, të gjeodezisë dhe hartografisë.	35 000
Specialist në drejtoritë apo sektorët e përmbajtjes përgjegjëse për funksionet e hartim-monitorimit të standardeve, të gjeoportalit kombëtar, koordinimit dhe projekteve, si dhe kërkim-zhvillimit dhe inovacionit.	31 000

**URDHËR****Nr. 101, datë 24.7.2023****PËR DELEGIMIN DHE DISA
RREGULLA TË PËRFAQËSIMIT LIGJOR
TË MINISTRISË SË BRENDSHME**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Brendshme, në proceset gjyqësore kur thirret si palë në një gjykim, lëshohen për aparatin nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë.

2. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Brendshme kur thirret si palë në gjykim, në proceset gjyqësore, në të cilat institucioni i varësisë ka lidhje me objektin e padisë, lëshohen në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë, nga drejtuesi i institucionit qendror ose i varësisë, sipas vendit ku është ngritur kërkesëpadi.

3. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri, si pjesë përbërëse e tij.

4. Përfaqësimi për çdo proces gjyqësor bëhet nga juristët dhe specialistët të fushës, sipas objektit të kërkesëpadi, nëpërmjet autorizimit të lëshuar nga autoritetet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij urdhri.

5. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Brendshme në proceset gjyqësore, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë, përfaqësuesit të autorizuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit, si dhe të drejtën për të hartuar, dorëzuar dhe nënshkruar kërkesëpadi.

6. Përfaqësuesit e autorizuar të ndjekin me korrektësi seancat gjyqësore, për sa i takon

pjesëmarrjes së tyre e veçanërisht kontributit provues, paraqitjes së kërkesave, prapësimeve, pretendimeve, ankimeve, rekurseve, si dhe dokumenteve të tjera, që do të ndihmonin mbrojtjen e përpiktë të interesave të institucionit të Ministrisë së Brendshme.

7. Në përfundim të proceseve gjyqësore, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda një afati 5-ditor nga shpallja/njoftimi i vendimit, të paraqitet informacion i detajuar, i shoqëruar (aty ky është e mundur) me vendimet përkatëse në Ministrinë e Brendshme.

8. Ngarkohen të gjitha institucionet e varësisë të Ministrisë së Brendshme, qendrore dhe vendore, të caktojnë një person përgjegjës, si pikë kontakti për të shkëmbyer çdo njoftim për ecurinë dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore.

9. Për autorizimet e lëshuara nga Sekretari i Përgjithshëm, deri në miratimin e këtij urdhri, të cilat janë përdorur pse përdoren për përfaqësim në proceset gjyqësore, efektet e urdhrit nr. 25, datë 18.1.2021 “Për delegim dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Brendshme” do të shtrihen edhe pas miratimit të këtij urdhri, deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

10. Ngarkohen institucionet e varësisë së Ministrisë së Brendshme, drejtoria që mbulon çështjet gjyqësore për aparatin dhe Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.

11. Ngarkohet sektori i arkiv protokollit për njoftimin e këtij urdhri institucioneve të varësisë së Ministrisë së Brendshme.

12. Urdhri nr. 25, datë 18.1.2021, “Për delegim dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Brendshme”, si dhe çdo dispozitë e përcaktuar në urdhra të tjerë që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Taulant Balla



Lidhja Nr. 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
(SEKRETARI I PËRGJITHSHËM/INSTITUCIONI I VARËSISË)

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2023

AUTORIZIM

Për përfaqësimin në çështjen civile/administrative me palë:

Paditës: _____

I paditur: _____

Person i tretë: _____

Objekti: _____

Në mbështetje të neneve 64-77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, të ligjit Nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe të urdhrit të Ministrit të Brendshëm Nr. ____, datë _____ “Për delegimin dhe disa rregulla të përfaqësimit ligjor të Ministrisë së Brendshme”;

VENDOSA:

Autorizimin e Z/Znj. _____, me detyrë _____, për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar kërkesë padinë / ankimin / rekursin, si dhe për të përfaqësuar Ministrinë e Brendshme, në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes civile/administrative me palë dhe objektin e sipërcituar, deri në shpalljen e vendimit në Gjykatën e Shkallës së Parë / në Gjykatën e Apelit / në Gjykatën e Lartë.

(SEKRETARI I PËRGJITHSHËM/DREJTUESI I INSTITUCIONIT)



URDHËR

Nr. 475, datë 20.7.2023

**PËR MIRATIMIN E FORMËS SË
DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT
TË PËRMBARUESIT GJYQËSOR
SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar dhe të nenit 28, pika 4 të ligjit nr 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”,

URDHËROJ

1. Miratimin e formës së dokumentit të identifikimit të përmbaruesit gjyqësor shtetëror, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit dhe përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.


3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave të nevojshme për njohimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

SHTOJCË NR. 1**FORMA E DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT TË PËRMBARUESIT GJYQËSOR
SHTETËROR**

Dokumenti i identifikimit të përmbaruesit gjyqësor shtetëror ka formë drejtkëndëshe, me përmasa 8.5 cm x 5.5 cm dhe është pronë e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror. Me sfond të bardhë, logon e drejtësisë në sfond dhe me shkronja të zeza. Fotografia e përmbaruesit gjyqësor shtetëror ka përmasa 3cm x 2 cm.

	MINISTRIA E DREJTËSISË SHËRBI MI PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHTETËROR DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT	
		
Emër Mbiemër _____ Përmbarues Gjyqësor Shtetëror _____ Zyra Përmbarimore _____		

- Shërbimi Përmbarimor në Republikën e Shqipërisë organizohet në Shërbim Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror dhe në Shërbim Përmbarimor Gjyqësor Privat.
- Organet shtetërore ose publike janë të detyruara të ndihmojnë përmbaruesit gjyqësorë në ushtrimin e funksioneve, sipas ligjit, sa herë kërkohet ndihma e tyre.
- Ky dokument përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
Drejtore i Përgjithshëm
(Emër Mbiemër) _____



GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 49516/17

*Mariglen AVDIU dhe të tjerë
kundër Shqipërisë*

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë) e mbledhur më 23 maj 2023, si Komision, i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *kryetar,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendësregjistrare e Seksionit,*

Duke pasur parasysh,

kërkesën (nr. 49516/17) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”), më 12 korrik 2017, nga kërkuesit e listuar në tabelën bashkëlidhur (“kërkuesit”), të cilët u përfaqësuan në Gjykatë nga Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve (“QEDR”), një organizatë joqeveritare me seli në Bruksel, Belgjikë dhe Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, një organizatë joqeveritare me seli në Tiranë;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me pretendimin për diskriminim ndaj kërkuesve si rezultat i moszbatimit nga Qeveria i masave për mos segregim në një shkollë fillore, që frekuentohej ekskluzivisht nga fëmijët e minoritetit rom.

2. Kërkuesit janë 15 familje me origjinë rome që jetojnë në Moravë, Berat, një fshat në Shqipëri, zonë në të cilën komuniteti rom përbën një të tretën e popullsisë.

3. Në kohën kur u depozitua kërkesa, fëmijët po ndiqnin ose priteshin të ndiqnin shkollën “Avdyl Avdya”, një shkollë fillore e ndërtuar në vitin 2002. Shkolla ofronte arsimin e detyruar fillor në klasa të grupuara. Numri i fëmijëve në shkollë varionte nga 23 në 29, dhe të gjithë ishin nxënës romë. Ato pak familje që nuk ishin rome i çonin fëmijët në shkollë të tjera.

4. Nxënësit nga shkolla “Avdyl Avdya” mund t’i përfundonin studimet e tyre të detyrueshme në shkollën “Shaban Sollaku” dhe të dyja shkollat ishin në të njëjtën njësi administrative. Në vitet e mëparshme, përpara kërkesës, vetëm pesë deri në gjashtë nxënës nga shkolla “Avdyl Avdya” i kishin vazhduar studimet në shkollën “Shaban Sollaku”. Sipas kërkuesve, kjo gjë ndodhte si pasojë e cilësisë së dobët të arsimit që nxënësit merrnin në shkollën “Avdyl Avdya”.

5. Pas një ankese të depozituar më 17 qershor 2015 nga QEDR-ja, më 16 korrik 2015, Drejtoria Rajonale e Arsimit Berat (Drejtoria e Arsimit) pranonte ekzistencën e segregimit ndaj fëmijëve romë në shkollën “Avdyl Avdya”, dhe nevojën për t’i dhënë fund kësaj situate. Megjithatë, Drejtoria e Arsimit parashtroi se transporti falas për fëmijët për të shkuar në shkollën “Shaban Sollaku” nuk ishte i mundur, sepse nuk përmbushej distanca minimale për ofrimin e transportit falas për nxënësit në një shkollë.

6. Pas një ankese tjetër të depozituar më 3 shtator 2015 nga QEDR-ja, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Shqipëri (“Komisioneri”), më 16 dhjetor 2015, mori një vendim sipas së cilit vlerësohej se kërkuesit ishin diskriminuar në fushën e arsimit nga Ministria dhe Drejtoria e Arsimit, për shkak të racës së tyre. Komisioneri urdhëroi zbatimin e hapave të nevojshëm duke përfshirë mbylljen e shkollës dhe transportin falas për fëmijët romë në një shkollë të integruar.

7. Më 10 prill 2018, kërkuesit informuan Gjykatën se nxënësit kërkues kishin filluar të ndiqnin shkollën “Shaban Sollaku”. Më 27 mars 2023, kërkuesit informuan Gjykatën se Ministria kishte miratuar mbylljen e shkollës “Avdyl Avdya”. Nxënësit kërkues kishin vijuar të ndiqnin shkollën e integruar, arsimimi i tyre kishte vijuar rregullisht, dhe ata ishin mirëpritur në shkollën e re. Autoritetet publike kishin organizuar transportin dhe prindërit ishin rimbursuar për shpenzimet e transportit, fillimisht me anë të palëve të treta dhe më pas nga Bashkia e Beratit. Kërkuesit nuk paraqitën ndonjë padi pranë gjykatave vendase ku të pretendonin se nuk kishte mjete efektive në çështjen e tyre.

LIGJI PËRKATËS VENDAS

8. Parashikimi përkatës i ligjit kundër diskriminimit, ligji nr. 10221, i datës 5 shkurt 2010, parashikon si më poshtë:

**Neni 1**

“Ky ligj rregullon zbatimimin dhe respektimin e parimit të barazisë për sa i përket racës, etnisë (...)”.

Neni 34

“1. Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për 17 dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale. 2. Paraqitja e ankimit përpara komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t'i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale.”

VLERËSIMI I GJYKATËS

9. Kërkuesit u ankuan mbështetur në nenin 1 të protokollit nr. 12 të Konventës, se ata ishin diskriminuar kundër të drejtës së tyre për një arsim përfshirës si rezultat i moszbatimit nga ana e autoriteteve i masave që shmangnin segregimin, për të adresuar mbipërfaqësimin e nxënësve romë në shkollën “Avdyl Avdya”.

10. Gjykata thekson se një vendim apo masë e favorshme për një kërkues në parim nuk është mjaftueshëm për të privuar kërkuesin nga statusi i tij i “viktimës” nëse autoritetet kombëtare nuk pranojnë shprehimisht ose në substancë, dhe më pas ofrojnë një zgjidhje për shkeljen e Konventës (shih *Murray kundër Holandës* [DHM], nr. 10511/10, § 83, 26 prill 2016, dhe *Nada kundër Zvicrës* [DHM], nr. 10593/08, § 128, GJEDNJ 2012). Pranimi apo zgjidhja zakonisht përftohen me anë të shterimit të mjeteve vendase (shih *Staykov kundër Bullgarisë*, nr. 49438/99, § 89, 12 tetor 2006 dhe *C dhe D kundër Kroacisë* (vendim), nr. 43317/07, 14 tetor 2010).

11. Në çështjen *X dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (nr. 73548/17 dhe 45521/19, § 63, 31 maj 2022), Gjykata thekson se mjetet vendase duhet të jenë “efektive” në kuptimin që ose të ndalojnë shkeljen e pretenduar ose ta ndërpresin atë, ose të ofrojnë zgjidhjen e duhur për çdo shkelje që tashmë ka ndodhur (shih *A.H. dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 6033/13 dhe 15 të tjerë, § 347, 17 janar 2017). Në atë rast, thelbi i ankesave të kërkuesve kishte të bënte me faktin se autoritetet nuk po ndërprisnin një situatë që vazhdonte, më konkretisht segregimin e

nxënësve romë/egjiptianë në një shkollë. Mbështetur në rrethanat, Gjykata vendosi se mjeti që ofronte perspektivën vetëm për kompensim financiar, pa ndaluar vijimësinë e shkeljes financiare, nuk mund të konsiderohej efektiv (shih *mutatis mutandis*, *Patranin kundër Rusisë*, nr. 12983/14, § 86, 23 korrik 2015).

12. Megjithatë, situata e kërkuesve në çështjen konkrete ndryshon, jo vetëm sepse autoritetet e pranuan se kërkuesit ishin diskriminuar, por edhe sepse ata e kompensuan situatën. Në lidhje me këtë gjë, Gjykata thekson se në vendimin e sipërpërmendur të datës 15 dhjetor 2015, Komisioneri pretendonte se Ministria dhe Seksioni i Arsimit kishin diskriminuar nxënësit romë në fushën e arsimit, duke përfshirë kërkuesit, për shkak të racës së tyre, pasi në shkollën “Avdyl Avdya” kishte pasur segregim. Në mbështetje të këtyre konstatimeve, Gjykata gjykon se autoritetet vendase kanë pranuar shprehimisht një shkelje të së drejtës të kërkuesve për t'u mos diskriminuar.

13. Në vijim, kërkuesit informuan Gjykatën se autoritetet vendase kishin ndërmarrë një sërë hapash për të adresuar ankesat e tyre. Shkolla “Avdyl Avdya” ishte mbyllur zyrtarisht në vitin 2018. Nisur nga semestri i dytë i vitit shkollor 2017/2018, Bashkia e Beratit kishte ofruar transport për fëmijët në shkollën e re dhe rimbursim për kostot e transportit për familjet përkatëse. Kërkuesit pohuan se cilësia e arsimit në shkollën e re ishte e përshtatshme.

14. Sipas Gjykatës, autoritetet përkatëse kanë respektuar detyrimin e tyre pozitiv për të ndërmarrë hapa për të korrigjuar pabarazinë e pretenduar ndaj kërkuesve dhe kanë shmangur segregimin e tyre në shkollën “Avdyl Avdya”.

15. Çështja tjetër që duhet të vlerësohet është nëse kërkuesit morën kompensimin e duhur për shkeljen e të drejtës së tyre për t'u mosdiskriminuar. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata përsërit se detyrimi për të shteruar mjetet vendase kërkon që kërkuesit të përdorin normalisht mjetet e disponueshme dhe të mjaftueshme, në lidhje me pretendimet e tyre për shkeljet të Konventës. Për të qenë efektiv, një mjet duhet të mund të kompensojë drejtpërsëdrejti aspektin e kundërshtuar të situatës dhe duhet të ofrojë perspektivën e arsyeshme për sukses (shih, për shembull, *Gherghina kundër Rumanisë*, [DHM] (vendim), nr. 42219/07, § 84, 9 korrik 2015).



16. Vendimi përfundimtar i Komisionerit ku pranohet shprehimisht diskriminimi i nxënësve kërkuar, i dha kërkuarve një mundësi të arsyeshme për të përftuar kompensim sipas nenit 34 të ligjit kundër diskriminimit (ligji nr. 10221 i datës 4 shkurt 2010), i cili parashikon se kushdo që është diskriminuar ka të drejtën të kërkojë kompensim për dëmet përpara një gjykate kompetente, pavarësisht nëse ai ose ajo ka depozituar një ankesë pranë Komisionerit. Megjithatë, kërkuar nuk kanë kërkuar kompensim me anë të një padie civile ndaj Shtetit. E teksa nisja e një procesi civil për shpërblim në vetvete nuk mund të shpërblejë plotësisht një shkelje të përsëritur për t'u mos diskriminuar, ky proces së bashku me pranimin nga ana e Komisionerit për një shkelje të së drejtës të tyre për t'u mosdiskriminuar, dhe masat pozitive për të adresuar diskriminimin, përmbushin kërkesat e efektivitetit. Gjithashtu, kur Komisioneri gjykon se është shkelur e drejta e kërkuarve për t'u mos diskriminuar, kërkuar duhet të ndjekin mjetet të përftuar kompensim për atë shkelje në të shkuarën. Kërkuar nuk e kanë bërë një gjë të tillë.

17. Sipas rrethanave, për sa ka të bëjë me ankesën e kërkuarve në lidhje me periudhën përpara muajit prill 2018, ajo duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 § 1 dhe 4 të Konventës për mosshkrim të mjeteve vendase.

18. Në lidhje me pretendimin e kërkuarve për periudhën pas muajit prill 2018, Gjykata tashmë ka vlerësuar se autoritetet kanë marrë masat e duhura për ta ndërprerë situatën për të cilën ankohen kërkuar (shih paragrafin 16 më sipër). Kërkuar nuk kanë paraqitur ndonjë argument apo informacione që do të tregonin të kundërtën. Rezulton se duke ndaluar segregimin në shkollimin e nxënësve kërkuar dhe duke iu siguruar mjetet e duhura të transportit në një shkollë ku nuk ka segregim, ku niveli i arsimit është i përshtatshëm, autoritetet vendase kanë kompensuar situatën e kërkuarve dhe për këtë arsye, kërkuar nuk mund të pretendojnë më të jenë viktimat të shkeljes së pretenduar.

19. Sipas rrethanave, për sa ka të bëjë me ankesën e kërkuarve në lidhje me periudhën që prej muajit prill 2018, ajo nuk përputhet *ratione personae* me parashikimet e Konventës sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) dhe për këtë arsye duhet të kundërshtohet sipas nenit 35 § 4.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,
E deklaroi kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar më shkrim më 15 qershor 2023.

Olga Chernishova
ZËVENDËSREGJISTRARE

Georgios A. Serghides
KRYETAR

SHTOJCË LISTA E KËRKUESVE

Nr.	Emri i kërkuar	Viti i lindjes/regjistrimit	Kombësia	Vendbanimi
1	Mariglen AVDIU	1998	shqiptar	Berat
2	Elio AVDIU	2013	shqiptar	Berat
3	Endri AVDIU	2004	shqiptar	Berat
4	Ermal AVDIU	1984	shqiptar	Berat
5	Eva AVDIU	2009	shqiptar	Berat
6	Flori AVDIU	2004	shqiptar	Berat
7	Iljaz AVDIU	1973	shqiptar	Berat
8	Leonard AVDIU	1987	shqiptar	Berat
9	Nadia AVDIU	2012	shqiptar	Berat
10	Paloma AVDIU	2009	shqiptar	Berat
11	Senada AVDIU	2007	shqiptar	Berat
12	Juliana MILE	2008	shqiptar	Berat
13	Klodjan MILE	1976	shqiptar	Berat
14	Nuri MILE	1975	shqiptar	Berat
15	Xhensia MILE	2004	shqiptar	Berat
16	Adelaide MYRTELI	2009	shqiptar	Berat
17	Adelajda MYRTELI	2009	shqiptar	Berat
18	Aleksandros MYRTELI	2008	shqiptar	Berat
19	Alex MYRTELI	2003	shqiptar	Berat



20	Alexandro MYRTELI	2008	shqiptar	Berat
21	Angelo MYRTELI	2008	shqiptar	Berat
22	Antonela MYRTELI	2014	shqiptar	Berat
23	Arjola MYRTELI	2003	shqiptar	Berat
24	Elton MYRTELI	1986	shqiptar	Berat
25	Ermal MYRTELI	1988	shqiptar	Berat
26	Gabriel MYRTELI	2011	shqiptar	Berat
27	Iljada MYRTELI	2005	shqiptar	Berat
28	Jolanda MYRTELI	1988	shqiptar	Berat
29	Kristo MYRTELI	2007	shqiptar	Berat
30	Laura MYRTELI	2008	shqiptar	Berat
31	Laureat MYRTELI	1982	shqiptar	Berat
32	Liverin MYRTELI	2016	shqiptar	Berat
33	Sentiljan MYRTELI	1986	shqiptar	Berat
34	Valter MYRTELI	1983	shqiptar	Berat
35	Vullnet MYRTELI	1968	shqiptar	Berat
36	Dallandyshe TIFI	1982	shqiptar	Berat
37	Danjel TIFI	2005	shqiptar	Berat
38	Manuel TIFI	2005	shqiptar	Berat
39	Elona YZEIRI	1984	shqiptar	Berat
40	Klaus YZEIRI	2004	shqiptar	Berat
41	Martino YZEIRI	2009	shqiptar	Berat
42	Vionis YZEIRI	2006	shqiptar	Berat

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË ÇËSHTJA ZEZO DHE SEAT SHPK KUNDËR SHQIPËRISË (Kërkesat nr. 61445/12 dhe 53157/15)

VENDIM

STRASBURG
22 qershor 2023

*Ky vendim është përfundimtar, por mund të bëhet objekt i
rishikimit redaktues.*

Në çështjen Zezo dhe Seat sh.p.k. kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
(Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komision, i
përbërë nga:

Ioannis Ktistakis, *kryetar,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendësregjistrare e
përkohshme e Seksionit,*

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 1 qershor
2023;

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në
po atë datë:

PROCEDURA DHE FAKTET

1. Çështja nisi me dy kërkesa kundër Shqipërisë
depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës
për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive
Themelore (“Konventa”) në data të ndryshme që
paraqiten në tabelën bashkëlidhur.

2. Lista e kërkuessve dhe detajet përkatëse të
kërkesave paraqiten në tabelën bashkëlidhur.

3. Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u vu në dijeni të
ankesave në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të
proceseve civile sipas nenit 6 të Konventës. Në
mbështetje të nenit 13 të Konventës, në çështjen nr.
53157/15, u komunikua një ankesë shtesë për
mungesën e mjeteve për adresimin çështjes së
kohëzgjatjes së proceseve.

LIGJI

I. BASHKIMI I KËRKESAVE

4. Duke pasur në konsideratë lëndën e ngjashme
të kërkesave, Gjykata e mendon të arsyeshme që t'i
shqyrtojë ato në një gjykim të vetëm.

II. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

5. Kërkuesit u ankuan se kohëzgjatja e
procedurave civile në fjalë nuk respektonte kërkesën
për “afat të arsyeshëm”. Ata iu referuan nenit 6 § 1
të Konventës.



6. Gjykata thekson se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet sipas rrethanave të çështjes dhe duke iu referuar kritereve të mëposhtme: kompleksiteti i çështjes, reagimi i kërkuësve dhe autoriteteve përkatëse dhe se çfarë ishte në rrezik për kërkuësit në këtë mosmarrëveshje (shih *Frydlender kundër Francës* [DHM], nr. 30979/96, §43, GJEDNJ 2000-VII; *Gazsó kundër Hungarisë*, nr. 48322/12, § 15, 16 korrik 2015; dhe *Topallaj kundër Shqipërisë*, nr. 32913/03, § 75 21 prill 2016).

7. Në çështjet referuese *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09 dhe 5 të tjerë, 1 prill 2014, dhe *Mishgioni kundër Shqipërisë* nr. 18381/05, 7 dhjetor 2010, Gjykata konstatoi një shkelje në lidhje me disa problematika të ngjashme me ato në çështjen konkrete.

8. Në kërkesën nr. 61445/12, kërkuësi u ankua vetëm për kohëzgjatjen e procesit në Gjykatën e Lartë. Procesi nisi më 9 tetor 2009 dhe përfundoi më 6 prill 2012, kur Gjykata e Lartë rrëzoi *de plano* rekursin e kërkuësit. Për këtë arsye, procesi zgjati për pothuajse dy vite e gjysmë në një shkallë të juridiksionit.

9. Sipas dosjes së çështjes, kërkuësi e nisi procesin ndaj palëve private në lidhje me detyrimet kontraktuale. Pas vendimeve të gjykatës së shkalës së parë dhe të apelit, Gjykata e Lartë u mbledh për të vendosur nëse i takonte këtyre dy gjykatave të vlerësonin *proprio motu* ligjshmërinë e kontratës.

10. Apeli në Gjykatën e Lartë nuk përmbante problematika ligjore veçanërisht komplekse, dhe Gjykata e Lartë nuk ndërmori asnjë hap procedural gjatë periudhës nën shqyrtim. Qeveria nuk paraqiti shpjegime për kohëzgjatjen e procesit pranë Gjykatës së Lartë. Nuk ka indicie se kohëzgjatja e procesit ishte për shkak të kompleksitetit të çështjes apo për shkak të kërkuësit. Për këtë arsye, koha që iu desh Gjykatës së Lartë për të lëshuar një refuzim *de plano* ishte e tepërt.

11. Në kërkesën nr. 53157/15, kërkuësi u ankua për procesin që filloi më 17 nëntor 2005 dhe përfundoi më 10 prill 2015, duke zgjatur për pothuajse nëntë vite dhe pesë muaj. Pas marrjes së padisë së kërkuësit për disa detyrime kontraktuale, Gjykatës së Rrethit Tiranë, gjykata e shkallës së parë, iu deshën më shumë se tre vite që të shpallte vendimin, më konkretisht më 10 dhjetor 2008, ne anë të të cilit gjykata vendoste të rrëzonte padinë e kërkuësit. Pas vendimit të gjykatës së apelit për të

prishur vendimin dhe për të nisur shqyrtimin, procesi përfundoi me vendimin e formës së prerë të datës 10 prill 2015, i cili u vu në dispozicion të kërkuësit më 24 prill 2015. Nuk ka fakte se kërkuësi kontribuoi në ndonjë mënyrë në kohëzgjatjen e procesit. Procesi nuk ishte kompleks, por nga ana e gjykatave vendase kishte pasur periudha të gjata mosveprimi.

12. Pasi shqyrtoi të gjithë materialin e dorëzuar pranë saj, Gjykata nuk konstatoi fakte apo argumente me anë të të cilave të justifikonte kohëzgjatjen e përgjithshme të procesit në nivel kombëtar për të dy aplikimet. Duke pasur në konsideratë praktikën e saj gjyqësore, Gjykata vendos se në të dyja kërkesat kohëzgjatja e procedurave ishte e tepërt dhe nuk përmbushte kërkesën për “afat të arsyeshëm”.

13. Për këtë arsye, këto kërkesa janë të pranueshme dhe konstatojnë një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

III. PRETENDIME TË TJERA PËR SHKELJE NË MBËSHTETJE TË PRAKTIKËS GJYQËSORE TË KONSOLIDUAR

14. Në kërkesën e tij nr. 53157/15, kërkuësi u ankua edhe në mbështetje të nenit 13 të Konventës për mungesë të mjeteve vendase për ankesën e tij për kohëzgjatjen e procesit. Duke iu referuar fakteve të çështjes, parashtrimeve të palëve dhe konstatimeve të mësipërme, Gjykata gjykon se ka shqyrtuar çështjen kryesore ligjore të paraqitur në kërkesën konkrete. Në këtë mënyrë, Gjykata konstaton se nuk është e nevojshme që të japë një vendim të veçantë për këtë ankesë (shih *Qendra për Burimet në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë* [DHM], nr. 47848/08, § 156, GJEDNJ 2014, dhe *Habilaj kundër Shqipërisë* [Komisioni], nr. 2480/10, § 14, 15 shtator 2022).

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

15. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

16. Duke iu referuar dokumenteve që kishte në përdorim, si edhe praktikës së saj gjyqësore (shih, veçanërisht, *Luli dhe të tjerët* dhe *Mishgioni*, cituar më sipër), Gjykata e gjykon me vend që të akordojë shumat e përcaktuara në tabelën bashkëlidhur.



PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

1. *Vendos* t'i bashkojë kërkesat;

2. *I shpall* ankesat e kërkuessve për kohëzgjatje të procesit civil sipas nenit 6 të Konventës të pranueshme, dhe vendos se nuk është e nevojshme që të shqyrtohet ankesa paraqitur në kërkesën nr. 53157/15 në mbështetje të nenit 13 të Konventës;

3. *Gjykon* se këto kërkesa paraqesin shkelje të nenit 6§1 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procesit civil;

4. *Gjykon*:

a) se Shteti përgjegjës, brenda tre muajve, duhet t'u paguajë kërkuessve shumat e përcaktuara në tabelën bashkëlidhur, të cilat duhet të konvertohen në monedhën e Shtetit përgjegjës, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

b) se që prej përfundimit të periudhës tremujore përmendur më sipër deri në shlyerje, duhet të paguhet një interes i thjeshtë për shumat e mësipërme në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së vonesës së pagesës plus tre për qind pikë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 22 qershor 2023, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSREGJISTRAR
I PËRKOHSHEM

Ioannis Ktistakis
KRYETAR

SHTOJCË
LISTA E KËRKUESVE QË PARAQESIN ANKESAT NË MBËSHTETJE
TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS
(KOHËZGJATJE E TEPËRT E PROCESIT CIVIL)

Nr.	Kërkesa nr. , data e dorëzimit	Emri i kërkuessit Viti i lindjes/ regjistrimit	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Nisja e procesit ose data e hyrjes në fuqi të Konventës për Shqipërinë (2 tetor 1996)	Përfundimi i procesit	Kohëzgjatja në total Nivelet e juridiksionit	Shuma akorduar për dëm jopasuror për kërkuess (në euro) ¹	Shuma akorduar për kostot dhe shpenzimet për kërkesë (në euro) ²
1	61445/12 18.9.2012	Enver Zeqo 1963		9.10.2009	6.4.2012	2 vite dhe 5 muaj dhe 29 ditë 1 nivel juridiksioni	900	-
2	53157/15 20.10.2015	SEAT sh.p.k. 2003	Lamaj Agron Tiranë	17.11.2005	10.4.2015 (vendimi marrë më 24.4.2015)	9 vite dhe 4 muaj dhe 25 ditë 4 nivele juridiksioni	800	250

¹ Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuessve.

² Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuessve.

GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 56080/19

2001 sh.p.k.

kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 30 maj 2023, si Komision, i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *kryetar*,

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendësregjistrare e Seksionit*,

Duke pasur parasysh,

kërkesën (nr. 56080/19) ndaj Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”), më 18 tetor 2019, nga një kompani shqiptare, “2001” sh.p.k, themeluar në vitin 2006 dhe me seli në Lezhë (“kompania kërkuese”), e cila u përfaqësua nga z. P. Ndreca, avokat i cili ushtron ligjin në Tiranë;

vendimin për të vënë në dijeni në lidhje me kërkesën Qeverinë Shqiptare (“Qeveria”), e cila u përfaqësua nga Agjenti i saj në atë periudhë, znj. B. Lilo dhe më pas z. O. Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Kërkesa ka të bëjë me drejtën për t’iu drejtuar gjykatës dhe kohëzgjatjen e procesit civil, si edhe aspektin e shterimit të mjeteve vendase, më konkretisht duke paraqitur ankesa përpara Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, në kontekstin ku ato gjykata nuk kishin mjaftueshëm gjyqtarë në staf për një periudhë të caktuar kohore.

A. Procesi vendas

2. Më 2 prill 2009, kompania kërkuese depozitoi një padi për dëmshpërblim në shumën prej 169,895,010 lekë (rreth 1,300,000 euro në periudhën konkrete) ndaj një pale private pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

3. Në një datë të papërcaktuar në vitin 2012, kompania kërkuese iu referua situatës së saj të vështirë financiare për t’i kërkuar gjykatës që të përjashtojë nga detyrimi për të paguar tarifën

gjyqësore, e cila, sipas ligjit vendas, përbënte një për qind të shumës së kërkuar. Gjykata e kundërshtoi kërkesën dhe i kërkoj kompanisë kërkuese që të paguante tarifën gjyqësore përkatëse.

4. Më 16 maj 2013, Gjykata e Rrethit Tiranë konstatoi se kompania kërkuese nuk e kishte paguar tarifën gjyqësore dhe ndërpreu shqyrtimin e padisë. Kompania kërkuese e apeloj vendimin, duke argumentuar se i përmbushte kushtet për t’u përjashtuar nga detyrimi për të paguar tarifën gjyqësore dhe se e drejta e saj për t’iu drejtuar një gjykate nuk mund të ndikohet nga një legjislacion dytësor që parashikonte detyrimin për shlyerjen e tarifës gjyqësore.

5. Më 20 nëntor 2013, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Ajo gjykoi se detyrimi për të paguar tarifën gjyqësore parashikohet nga ligji dhe ndërprerja e procesit nga gjykata e shkallës së parë ishte i justifikuar. Më 25 nëntor 2013, kompania kërkuese depozitoi një rekurs në Gjykatën e Lartë.

6. Më 18 tetor 2019, kompania kërkuese depozitoi pranë Gjykatës kërkesën konkrete, që më pas iu komunikua Qeverisë më 10 maj 2021.

7. Më 14 korrik 2021, Gjykata e Lartë e rrëzoi si të papranueshëm rekursin depozituar nga kompania kërkuese pranë Gjykatës së Lartë.

8. Më 28 shkurt 2022, kompania kërkuese paraqiti parashtrimet e saj përfundimtare pranë Gjykatës, duke përfshirë pretendimet për dëmshpërblim të drejtë.

B. Kuadri ligjor përkatës dhe informacioni për Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese

9. Neni 31 § 2 i ligjit për gjyqësorin (ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”) parashikon se, si rregull, trupi gjykues për proceset civile në Gjykatën e Lartë i shqyrton rekursin në trupa gjyqësore të përbërë nga tre gjyqtarë.

10. Sipas nenit 399/6 të Kodit të Procedurës Civile (“KPC”), në rastin kur një çështje është pezull pranë një trupe gjyqësore në Gjykatën e Lartë, ankesat në lidhje me kohëzgjatjen e procesit do të duhet të dëgjohen nga një trupë tjetër gjyqësore në Gjykatën e Lartë (shih *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, nr. 43391/18 dhe 17766/19, § 37, 12 tetor 2021).

11. Pas një sërë shkarkimesh dhe dorëheqjesh të gjyqtarëve nga detyra, nga data 22 maj 2019 deri më 18 mars 2020, Gjykatës së Lartë i mungonte kuorumi statutor prej tre gjyqtarësh për shqyrtimin e padive pranë saj. Gjykata e Lartë e rifitoi kuorumin



minimal të gjyqtarëve më 18 maj 2020, dhe gjatë muajve në vijim u emëruan gjyqtarë të tjerë.

12. Për sa i përket Gjykatës Kushtetuese, sipas të dhënave zyrtare, nga data 16 korrik 2018 deri më 14 nëntor 2019, gjykatës i mungonte kuorumi statutor i gjyqtarëve prej tre gjyqtarësh për të shqyrtuar apelimet pranë saj. Ajo e rifitoi kuorumin minimal të gjyqtarëve më 14 nëntor 2019, dhe gjatë muajve në vijim u emëruan gjyqtarë të tjerë.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Pretendim për shkelje të nenit 6 të Konventës

13. Kompania kërkuese u ankua në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës për refuzimin nga ana e gjykatave vendase për ta përjashtuar nga tarifa gjyqësore, dhe vlerësonte se meritat e padisë së saj paraqisnin një shkelje të të drejtave të saj për t'iu drejtuar gjykatës. Sipas së njëjtit parashtrim, kompania kërkuese u ankua për një kohëzgjatje të tepruar të procesit. Në vijim, në mbështetje të nenit 13 të Konventës, kompania kërkuese u ankua se nuk kishte asnjë mjet vendas efektiv për ankesat e saj.

14. Qeveria parashtrroi se kompania kërkuese nuk kishte shteruar mjetet vendase. Kompania kërkuese e kundërshtoi pretendimin, duke argumentuar se në periudhën kur kompania kërkuese kishte depozituar kërkesën e saj pranë Gjykatës, nuk ekzistonin mjetet vendase efikase për t'u shteruar.

15. Parimet e përgjithshme në lidhje me shterimin e mjeteve vendase dhe parimi i subsidiaritetit janë përmbledhur në vendimin *Vučković dhe të tjerët kundër Serbisë* ((kundërshtimi paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, §§ 69-77, 25 mars 2014). Veçanërisht për sa i përket Shqipërisë, pas ndryshimeve të datës 12 gusht 2016 në lidhje me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, në parim, një rekurs kushtetues bëhej mjeti efektiv për t'u shteruar për të gjitha ankesat e bëra në mbështetje të Konventës (shih *Fullani kundër Shqipërisë*, (vendim) nr. 4586/18, § 79, 20 shtator 2022). Gjithashtu, në lidhje me ankesat për kohëzgjatjen e procesit, mjeti i ri që hyri në fuqi më 5 nëntor 2017, në parim duhet të shterohet përpara depozitimit të një ankese pranë Gjykatës (shih *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, nr. 43391/18 dhe 17766/19, § 119, 12 tetor 2021).

1. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës

16. Gjykata thekson se më 18 tetor 2019, kur kompania kërkuese depozitoi kërkesën konkrete pranë Gjykatës, Gjykata e Lartë dhe Gjykata

Kushtetuese në të vërtetë nuk mund të merrnin një vendim të menjëhershëm për ankesën e saj në lidhje me të drejtën e saj për t'iu drejtuar gjykatës, ankesë e cila tashmë është përpara Gjykatës. Megjithatë, nuk diskutohet që kjo ishte një situatë e përkohshme që autoritetet vendase po përpiqeshin ta adresonin, dhe që gjykatat më të larta po pranonin rekurse të depozituar pranë tyre në mënyrën tradicionale. Gjithashtu, palët nuk trajtojnë midis tyre se më 14 korrik 2021, datë kur Gjykata e Lartë shpalli vendimin për rekursin e kompanisë kërkuese në Gjykatën e Lartë (shih paragrafin 7 më sipër), Gjykata Kushtetuese ishte operative. Në të vërtetë, në atë periudhë, Gjykata Kushtetuese kishte qenë operative për më shumë se 21 muaj, që prej datës 14 nëntor 2019, datë në të cilën kishte rifituar kuorumin e nevojshëm për të gjykuar për disa prej rekurseve depozituar pranë saj (shih paragrafin 12). Edhe pse mundësia praktike e dëgjimit të rekursit kushtetues u mundësua vetëm pas datës së depozitimit të kërkesës së saj, kompanisë kërkuese iu kërkuo sidoqoftë që ta shteronte atë mjet për të drejtën e saj për ta drejtuar ankesën në gjykatë.

17. Në parashtrimet e saj të fundit, më 28 shkurt 2022 pranë Gjykatës, kompania kërkuese nuk bëri të qartë nëse kishte paraqitur një ankesë kushtetuese ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë. Nëse ajo e ka depozituar një rekurs të tillë kushtetues, nuk ka ende asnjë indicie se Gjykata Kushtetuese ka nisur gjykimin për të. Për këtë arsye, kjo ankesë pranë Gjykatës në çdo rast është e parakohshme (shih në të njëjtin koncept, *Gjinarrari kundër Shqipërisë* (vendim) [Komisioni], nr. 52610/19, §§ 14 dhe 20, 22 nëntor 2022). I takon kompanisë kërkuese që të ridepozitojë ankesën pranë Gjykatës pas shterimit të mjeteve vendase.

2. Kohëzgjatja e procesit

18. Në lidhje me pretendimin për shkelje të kërkesës për “afat të arsyeshëm”, sipas nenit 6 § 1 të Konventës, që prej datës 5 nëntor 2017, sistemi ligjor shqiptar ka parashikuar një mjet të posaçëm në lidhje me këtë ankesë, i cili ka të bëjë me masën kompensuese dhe/ose përshpejtuese sipas nenit 399/1 e në vijim të KPC (shih *Bara dhe Kola*, cituar më sipër, §§ 37 dhe 119).

19. Në periudhën midis datës 5 nëntor 2017 dhe 22 maj 2019, periudhë në të cilën Gjykata e Lartë humbi përkohësisht kuorumin e nevojshëm për të gjykuar çfarëdo kërkesë (shih paragrafët 10 dhe 11 më sipër), çështja e kompanisë kërkuese ishte ende



pezull pranë Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye, i takonte kompanisë kërkuese të depozitonte një padi dhe të merrte vendimin e Gjykatës së Lartë sipas nenit 399/1 e në vijim të KPC. Në të vërtetë, gjykata mori dhe gjykoi çështje të tjera të ngjashme gjatë asaj periudhe (shih *Bara dhe Kola*, cituar më sipër, §§ 39-43). Megjithatë, kompania kërkuese nuk e përdori atë mundësi për të paraqitur ankesën e saj për kohëzgjatjen e procesit pranë Gjykatës së Lartë.

20. Nga data 22 maj 2019 deri më 18 mars 2020, Gjykatës së Lartë i mungonte kuorumi për shqyrtimin e një padie të mundshme, sipas nenit 399/1 e në vijim të KPC, gjë e cila, është e kuptueshme, që mund të ketë shkaktuar ngurrim për kompaninë kërkuese që ta paraqiste atë kërkesë pranë gjykatës. Megjithatë, theksohet përsëri se pranë Gjykatës nuk u ngrit çështja se mungesa e kuoromit ishte një situatë e përkohshme dhe për këtë arsye çdo kërkesë depozituar pranë gjykatës gjatë asaj periudhe do të shqyrtohej sapo Gjykata e Lartë të rifitonte kuorumin e nevojshëm. Në të vërtetë, Gjykata e Lartë rifitoi kuorumin e nevojshëm më 18 mars 2020 (shih paragrafin 11 më sipër), datë në të cilën pranë saj nuk kishte asnjë kërkesë pezull paraqitur nga kompania kërkuese sipas nenit 399/1 e në vijim të KPC-së.

21. Së fundmi, nuk kishte asnjë arsye që e pengonte kompaninë kërkuese të paraqiste një kërkesë të tillë pranë gjykatës në periudhën nga data 18 mars 2020 dhe 24 korrik 2021, datë në të cilën Gjykata e Lartë e rrëzoi rekursin depozituar pranë saj në lidhje me meritat e mosmarrëveshjes (shih paragrafin 7 më sipër dhe *Bara dhe Kola*, cituar më sipër, § 15, ku tregohet se gjatë asaj periudhe Gjykata e Lartë gjykante kërkesat e depozituara nga palë të tjera sipas nenit 399/1 e në vijim të KPC).

22. Në një vlerësim të përgjithshëm për rrethanat specifike të çështjes konkrete dhe pavarësisht çdo ngurrimi të krijuar nga mungesa e gjyqtarëve të mjaftueshëm në Gjykatën e Lartë për një periudhë të caktuar, Gjykata është e mendimit se kompanisë kërkuese, sidoqoftë, i është kërkuar që t'i jepte gjykatës mundësinë që të gjykante ankesën e saj për pretendimin për kohëzgjatje të procesit sipas nenit 399/1 e në vijim të KPC. Pasi një gjë e tillë nuk u përmbush, ankesa është e papranueshme për mosshfrytëzim të mjeteve vendase sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

B. E drejta për një mjet efektiv

23. Kompania kërkuese e kishte pasur mundësinë për të paraqitur ankesat e saj pranë autoriteteve vendase (shih paragrafët 17 dhe 22 më sipër). Ankesa e saj në mbështetje të nenit 13, së bashku me nenin 6 të Konventës, se nuk kishte mjete efektive për të adresuar ankesat e saj, për këtë arsye është e pambështetur në fakte sipas interpretimit të nenit 35 § 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime, *E deklaroi* kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar më shkrim më 22 qershor 2023.

ZËVENDËSREGJISTRARE

Olga Chernishova

KRYETAR

Georgios A. Serghides

GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 34712/18

Rabije HAKA

kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 30 maj 2023, si Komision, i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *kryetar*,

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*,

dhe Olga Chernishova, *zëvendësregjistrare e Seksionit*,

Duke pasur parasysh,

kërkesën (nr. 34712/18) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa"), më 14 korrik 2018, nga një shtetase shqiptare, znj. Rabije Haka, lindur në vitin 1981 dhe me banim në Tiranë ("kërkuessa"), e cila u përfaqësua nga znj. Gollosi, avokate e cila e ushtron ligjin në Tiranë;

vendimin për të bërë me dije mbi kërkesën Qeverinë shqiptare ("Qeveria"), përfaqësuar nga Agjenti i saj z. A Metani, dhe në vijim nga z. O. Moçka, nga Avokatura e Shtetit;

parashtrimet e palëve;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:



LËNDA E ÇËSHTJES

1. Në një datë të papërcaktuar, bashkëshorti i kërkujes depozitoi një padi pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë me anë të së cilës kërkonte t'i paguhej pensioni i plotë për paaftësi për punë për periudhën nga data 31 mars 2007 deri më 24 nëntor 2009. Më 12 tetor 2011, gjykata e shkallës së parë e mbështeti kërkesën. Megjithatë, pasi i pandehuri depozitoi një apelim, më 24 maj 2012, Gjykata e Apelit Tiranë e kundërshtoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e rrëzoi pretendimin e bashkëshortit të kërkujes. Kur bashkëshorti i kërkujes ndërroi jetë, kërkuësja mori përsipër të ndiqte procedurat. Ajo depozitoi një apelim pranë Gjykatës së Lartë, e cila e rrëzoi më 17 dhjetor 2015.

2. Më 8 nëntor 2016, ligji nr. 99/2016 i datës 6 nëntor 2016 u publikua në Fletoren Zyrtare. Sipas këtij ligji, shkurohej afati për depozitimin e një ankese kushtetuese nga dy vite në katër muaj për “konstatimin e cenimit” [sipas së drejtës ose lirisë kushtetuese]. Gjithashtu, ligji parashikonte se afati i ri duhej të hynte në fuqi më 1 mars 2017.

3. Më 14 nëntor 2017, kërkuësja depozitoi një ankesë kushtetuese, e cila u deklarua e papranueshme nga Gjykata Kushtetuese më 16 janar 2018 pasi ishte depozituar jashtë afatit katërmujor, ku përlllogaritja niste prej datës 17 dhjetor 2015, datë në të cilën ishte miratuar vendimi i Gjykatës së Lartë.

LIGJI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE VENDASE

4. Ligji përkatës vendas në lidhje me afatin e ri për depozitimin e një ankese kushtetuese përcaktohet në çështjen *Çela kundër Shqipërisë* (nr. 73274/17, §§ 7 dhe 8, 29 nëntor 2022).

5. Më 16 qershor 2017, Gjykata Kushtetuese shpalli dy vendime të veçantë në çështjet Pajova (vendimi nr. 157) dhe Ibrahim (vendimi nr. 152), te të cilët u zbatua afati i ri katërmujor për vendimet e Gjykatës së Lartë, të cilat u miratuan më 7 maj 2015 dhe 25 qershor 2015 respektivisht, duke e nisur përlllogaritjen nga data e miratimit të tyre.

VLERËSIMI I GJYKATËS

6. Parimet e përgjithshme për të drejtën për t'u drejtuar Gjykatës Kushtetuese në lidhje me afatin e ri katërmujor për depozitimin e një ankese kushtetuese janë përmbledhur në çështjen *Çela* (citur më sipër, §§ 20, 27-29 dhe 32).

7. Gjykata thekson se vendimi i formës së prerë dhënë nga Gjykata e Lartë u miratua më 17 dhjetor

2015 dhe se në atë periudhë afati për depozitimin e një ankese kushtetuese ishte dy vite, duke e nisur llogaritjen që prej miratimit të vendimit të Gjykatës së Lartë. Ligji i ri, që e shkurtonte atë afat në katër muaj, u publikua më 8 nëntor 2016 dhe parashikonte se afati i ri do të ishte i zbatueshëm duke filluar nga data 1 mars 2017. Kërkuësja e depozitoi ankesën e saj kushtetuese më 14 nëntor 2017, brenda afatit dyvjeçar. Megjithatë, ankesa u shpall e papranueshme nga Gjykata Kushtetuese pasi ishte depozituar përtej afatit katërmujor, duke e nisur llogaritjen nga data e miratimit të vendimit të Gjykatës së Lartë.

8. Gjykata vëren se, fillimisht, kur u miratua ligji që parashikonte afatin katërmujor, nuk ishte e qartë nëse ky ligj do të zbatohet edhe për vendimet e kontestuara të miratuara përpara datës 1 mars 2017 (shih *Çela*, cituar më sipër, §§ 39-39). Gjykata Kushtetuese e bëri të qartë pozicionin e saj më 16 qershor 2017, me miratimin e vendimeve Pajova dhe Ibrahim (shih paragrafin 5 më sipër, shih edhe *Çela*, cituar më sipër, § 6), duke lënë në fuqi parashikimin se afati dyvjeçar ndalonte së zbatuari pas datës 1 mars 2017, dhe se çdo ankesë kushtetuese e depozituar pas asaj date do t'i nënshtrohej afatit katërmujor për të gjitha çështjet pa përjashtim. Në praktikë, një gjë e tillë nënkuptonte se për sa i përkiste të gjitha çështjeve ku vendimi i Gjykatës së Lartë (apo një vendim tjetër i formës së prerë i kundërshtuar) ishte miratuar përpara datës 1 nëntor 2016, ankesa kushtetuese do të duhej të depozitohej deri më 1 mars 2017, por nëse depozitohej më vonë, atëherë ajo do të deklarohet e papranueshme.

9. Në rrethanat e ngjashme në çështjen *Çela*, Gjykata tashmë ka vendosur se interpretimi për afatin e ri nuk kishte qenë mjaftueshëm i parashikueshëm për ankuesit e mundshëm kushtetues më 1 mars 2017. Megjithatë, pas vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të datës 16 qershor 2017 (shih paragrafin 5 më sipër), së bashku me vendimin e gjykatës në çështjen *Çela*, Gjykata gjykon se pozicioni se afati i ri i zbatuar për të gjitha vendimet e apeluara të shpallura përpara datës 1 mars 2017 do të duhej të konsiderohej se përbënte një praktikë të konsoliduar për të cilën kërkuësja duhej të ishte në dijeni (krahaso *Çela* cituar më sipër, § 37). Megjithatë, edhe nëse afati katërmujor do të llogaritej nga momenti kur pozicioni i Gjykatës Kushtetuese u bë i qartë, kërkuësja e depozitoi



ankesën e saj kushtetuese jashtë afatit. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata përsërit se pranon se nuk është shkelur e drejta e kërkuar për t'iu drejtuar një gjykate, ku parashikimet ligjore që mund të mos ishin të qarta ishin plotësuar me një praktikë gjyqësore të konsoliduar e cila ishte publikuar dhe ishte e aksesueshme dhe mjaftueshëm precize për t'i mundësuar kërkuar (nëse do të ishte e nevojshme, me anë të një këshillimi profesional) të vendoste se çfarë hapash duhej të merrte (shih *Cañete de Goñi kundër Spanjës*, nr. 55782/00, § 41, GJEDNJ 2002-VIII).

10. Në këto rrethana, Gjykata është e mendimit se ankesa e kërkuar se nuk kishte pasur të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese është qartazi e pambështetur në fakte, pasi mungon indicia për një shkelje të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës parashikuar në nenin 6 të Konventës, dhe veçanërisht kërkesa për parashikueshmëri (shih, për parime të përgjithshme *Zubac kundër Kroacisë* [DHM], nr. 40160/12, §§ 76-99, 5 prill 2018).

11. Për këtë arsye, kjo pjesë e kërkesës duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 § 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,
E deklaroi kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar më shkrim më 22 qershor 2023.

ZËVENDËSREGJISTRARE

Olga Chernishova

KRYETAR

Georgios A.
Serghides

VENDIM

Nr. 216, datë 4.7.2023

MBI NJOHJEN E LICENCËS PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE, LËSHUAR NGA ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR SUBJEKTIN “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS SHPK”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 97, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pikat 4, 5 dhe 6 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe

heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; “Memorandumin e mirëkuptimit për njohjen reciproke të licencave për veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike ndërmjet autoriteteve kombëtare rregullatore të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 245, datë 6.12.2021; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1721/4 prot., datë 29.6.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike, vazhduar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, për subjektin ‘Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k.’”,

konstatoi se:

- Subjekti “Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k.”, dega në Tiranë, degë e shoqërisë së huaj, me shkresën e datës 24.3.2022, protokolluar në ERE me nr. 1721 prot., datë 1.6.2023, ka paraqitur kërkesën për njohje të licencës për furnizimin me energji elektrike, me numër ZRRE/Li_55/16, të lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji në Republikën e Kosovës, me vendimin V_1734_2023, datë 5.5.2023.

- Më herët, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 117, datë 24.5.2022, ka miratuar njohjen e kësaj licence, dhënë me vendimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, me vendimin V_968_2018, datë 13.4.2018.

- ERE me *e-mail*-in e protokolluar me nr. 1721/1 prot., datë 13.6.2023, i paraqiti Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës kërkesën për informacion, në lidhje me vlefshmërinë e kësaj licence dhe në rast se kjo zyrë ka ndërmarrë ndonjë veprim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.

- ZRRE Kosovë me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 1721/3 prot., datë 27.06.2023, ka njoftuar se nuk ka filluar dhe as ka ndërmarrë ndonjë vendim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.

- Subjekti ka depozituar në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga neni 4, pika 4, dhe shtojca 1/K e “Rregullores për procedurat dhe



afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”. Po ashtu, ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

- Afati i njohjes së licencës do të jetë i njëjtë me afatin e licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, për shoqërinë “Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k.”, deri më 12.4.2028.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë njohjen e licencës për furnizimin me energji elektrike nr. ZRRE/Li_55/16, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, me vendimin V_1734_2023, datë 5.5.2023, për subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k.”, që ka regjistruar në Shqipëri subjektin “Future Energy Trading and Exchange Dynamics sh.p.k.”, dega në Tiranë.

2. Njohja e licencës sipas përcaktimeve të pikës 1 është e vlefshme deri më 12.4.2028.

